



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 08 / Gusht 2025



EGOJA **KY ARMIK** **I NJERIUT**



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 08 (507)


Gusht, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Vështirësitë e lehtësive për të cilat lutemi
Mehmet Disha

në fokus

- 08** Egoja ky armik i njeriut
Feim Hoxha

lajme / aktivitete

- 10** 01-Diplomohet brezi i katërt i studentëve të institutit të studimeve islame “Hafiz Sabri Koçi”
02-Rektorët e universiteteve saudite nderojnë kryetarin Spahiu për kontributin e tij
03-Kryetari Spahiu pret Ambasadoren e Algjerisë në KMSH
04-Ambasadori i Ambasadës së shtetit të Palestinës në vendin tonë viziton KMSH-në
05-Xhamia e re e Librazhdit mirëpret besimtarët për xhumanë e parë
06-Kryetari Spahiu pret në KMSH kreun e unionit të bashkësive islame shqiptare në Gjermani

refleksione

- 16** Përrenjtë e vegjël
Alija Iztbegović

çështje fetare

- 18** Shkenca e Tasavufit
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

familja

- 20** Lërimi fëmijët ta jetojnë fëmijërinë
Aisa Kokiçi

horizonti i besimit

- 22** Prefekti i parë i Mekës pas Islamit
Tauland Bica
24 Besnikëria është cilësi e besimtarit
Dorian Demetja
26 Drita e besimit në kohët moderne
Abdullah Bulku
28 Në lidhje me përgojimin
Bediuzzaman Said Nursi
30 E mesmja e artë e umetit islam
Dr. Muhamed Amareh

bota shpirtërore

- 34** Para Zotit tënd
Redaksia

hapësirë fëminore

- 36** Paguaj sa të duash
Hapësire Fëminore

këndi i poezisë

- 38** Fjala e dëshmisë
Mexhit Yveysi



Vështirësitë e lehtësive për të cilat lutemi



Rruga e lehtë e Imanit

Po ta shikojmë njeriun si një krijim, si një pronë që ka një përkatësi, si një vepër arti që ka një Artist, si një ndërthurje mjeshtërore dhe e mrekullueshme e inxhenerisë së hollësishme dhe të detajshme në krijim dhe në formë, do të vërejmë se Krijuesi i Plotfuqishëm e ka krijuar atë në formën e një universi të vogël, si shembëllturyrë piktoreske në miniaturë e Universit të tejskajshëm brenda të cilit gjendet kjo botë. Kaq i vogël sa është njeriu, e prap', nderthurja artistike në krijimin e tij, e bën atë nevojtar dhe lutës ndaj një sërë gjërash gati të panumërta, duke filluar që nga nevojat fizike e gjer tek ato shpirtërore, i ndërfutur ngushtë me botët dhe gjithësinë mbarë dhe në këtë gjithësi kaq të gjerë, ku nevojat e tij plotësohen në mënyrë të jashtëzakonshme dhe të përpiktë.

Për të njohur Krijuesin dhe për të dëshmuar mrekullitë, për të zgjuar veten nga ndonjë përgjumje e shpejtë dhe për të mos u përhumbur në gaflet, nuk është nevoja të shohim larg, por mjafton të kthehemi e të hedhim vështrimin me meditim drejt vetes dhe të shkuarës tonë: Rrugëtimi i njeriut prej një fare te formësuar nga gjenet e babait, drejt nënës, më pas prej nënës, drejt botës vërehet që bëhet me një lehtësim dhe një plotësim që nuk është në dorën e askujt tjetër veçse të Krijuesit. Formësimi, krijimi, ngjizja, mpiksja, kockat, mishi, organet, molekulat, qelizat, fytyra, gjymtyrët, detajet e të gjitha sikur dalin (dhe e vërteta është që dalin) nga e fshehta, nga gajbi, duke dëshmuar versetin e qartë kuranor:

هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

"Ai ju formëson në mitër, ashtu siç dëshiron Vetë; s'ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit!..."¹

Po kështu, ndërrimi i natës dhe i ditës, i stinëve dhe i erërave, i reve dhe i ndodhive të përditshme, na rikujtojnë fuqinë absolute dhe na lehtësojnë të kuptuarit e gjërave që nuk i kemi në dorë dhe që nuk duhet të na shqetësojnë.

Tanimë, problemi qëndron se, kur njeriu, i lodhur nga rrugët e gabuara, i lodhur nga egoja dhe iluzionet e qenies, nga gjynahet dhe nga dobësitë e nefsit, nga dashuritë metaforike të rrejshme dhe nga trazimet e dynjasë dhe gjërat e pafundme me të cilat ai është i preokupuar dhe nga të cilat ndikohet me zemër, kthehet e sheh drejt të tashmes apo së ardhmes, bllokohet disi dhe fillon e zë paniku, dhe si rrjedhojë e përhumbjes, harresës se nga ka ardhur, si pasojë e dobësisë së Imanit,

shkëputjes së lidhjes me Kur'anin, dhikrin e lutjen, si rrjedhojë e humbjes së busullës, ngaqë i janë ndërfutur qëllime dynjaje dhe ka lënë pas dore qëllimin kryesor që është fitimi i kënaqësisë së Allahut, dhe kështu i është ndërveshur syfaqësia dhe humbja e sinqeritetit- ihlasit, dhe si pasojë e dembelizmit në rrugën e ndjekjes së Sunetit profetik, dëshpërohet dhe shastis rrugën duke harruar se Allahu është Ai që ka në kontroll gjithçka dhe se rruga nuk duhet të qe aq e vështirë.

Krijuesi është Ai që na krijoi nga hiçi. Ne s'dinim gjë për këtë ekzistencë, s'kishim ndonjë pritshmëri. Dashuria e Tij na stisi, na dha formë, udhë,

مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ
مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَرَهُ
ثُمَّ السَّبِيلَ يَسْرُهُ

"Po nga se e Krijoi Zoti atë?

Prej një fare të vogël i dha krijim,

Pastaj rrugën ja bëri të lehtë..."²

Çdo gjë tjetër është thjesht një urë, një sebeb, një shkak një kalim që Zoti e ka bërë të tillë në formë perdeje dhe Fuqia e Vërtetë është vetëm se prej Zotit. Shkaqet nuk kanë kurrfarë fuqie në vetvete përveçse me Shkaktarin e Vërtetë! Atij asgjë nuk i vjen rëndë. Mund të bëjë gjithçka. Atomit për Të është njësoj si yjet. E pjesshmja është njësoj e lehtë për të si e përgjithshmja. Si një njeri, si miliona njerëz, në krijim për të janë njësoj për sa i përket lehtësimit. Madje një gjë e vogël, shpeshherë, është artistikisht shumë herë më e sofistikuar se diçka e madhe në formë. Për të, krijimi i një luleje, është po aq i kollajtë sa krijimi i një paranvere të tërë në rruzullin tokësor! Të gjitha ndodhitë e mrekullueshme që kërkojnë fuqi të jashtëzakonshme dhe që kanë ndodhur në të shkuarën, tregojnë se Ai është i plotfuqishëm që t'i bëjë ato edhe në të ardhmen! Ai që solli të djeshmen, sjell edhe të nesërmen, po kështu, Krijuesi i Plotfuqishëm i të shkuarës, do të krijojë edhe të ardhmen. Ai Krijues i Urtë e i Plotpushtetshëm që ka krijuar dynjanë, do të krijojë edhe Ahiretin dhe e ka fuqinë për këtë gjë!³ Atëherë si është e mundur që në këtë modernitet materialist, në këto mkohëra të fundme, besimtari e humb udhën dhe harron se për nga duhet të drejtohet?

Njeriu është një pasqyrë e pastër që dëshmon ekzistencën dhe Njeshmërinë e Krijuesit në çdo aspekt absolut të ekzistencës dhe më së miri mbledh në vetvete pasqyrimin e pafundëm të Emrave të Bukur Hyjnorë që shpërfaqen në bazë të nevojave tek njeriu, kështu, duhet kuptuar më

1. Kur'an, Ali Imran, 3:6

2. Kur'an, Abese, 80:18-19-20.

3. Bediuzzaman Said Nursi, Mektubat, fq. 226.

së miri se edhe në një botë të lëmshtë, iluzioni nuk i bën dot hije e aq më pak ta mbulojë Njëshmërinë e Allahut. Kësaj gjëje i hedh dritë qartë ajeti: kuranor:

مَا خَلَقَكُمْ وَلَا يَعْتَكُمُ إِلَّا كَنَفْسٌ وَاحِدَةٌ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

"Krijimi dhe ringjallja e të gjithë juve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha."⁴

Qëllimet e larta

Mirëpo krijimi i njeriut nuk mbaron me përmbushjen e formës së jashtme. Nuk mund të thuhet se një njeri është i përsosur dhe tamam njeri përderisa ai thjesht zhvillohet në formën e jashtme, me trupin fiziki si i tillë. Edukimi i njeriut merr vite dhe ka një sërë peripecish që madje mund ta pengojnë atë proces... Trupi sidoqoftë është i përkohshëm. Njeriu nuk është krijuar që t'i shëqrbet vetëm anës së jashtme që në gjuhën e thuasë të gjitha filozofive, është cilësuar si anë kafshërore – anima. Po shpirti?

Pikërisht këtu janë vendosur shkallët e rritjes së njerëzores drejt horizonteve të larta ku tejkalohen edhe engjëjt. Qasja fetare këtu është jashtëzakonisht e gjerë dhe e detajshme.

Në mënyrë të përgjithshme mund të themi se kjo botë është një arenë e përkohshme mundësie për të fituar përjetësinë, një garë për të dalluar shpirtat në bazë të zgjedhjeve dhe punëve që bëjnë, ku qëllimi kryesor është njohja dhe dëshmia e Krijuesit dhe e të gjitha mirësive të krijimit që Ai shfaq çdo sekondë, minut, orë e ditë, çdo javë, çdo muaj e çdo vit nëpërmjet mrekullive të shfaqjes. Ndjekja e udhëimit që vjen prej Tij nëpërmjet shpalljes dhe profetëve. Ndjekja e anës së pastër të ndërgjegjes dhe zemrës. Mosanimi nga e keqja, ruajtja nga çdo gjë brenda dhe jashtë vetes që fton për tek e keqja e cila trazon ndërgjegjen. Ruajtja nga ajo që e prosh imdividin dhe, më gjerë, të gjithë shoqërinë.

4. Kur'an, Lukman, 31:28.

Ruajtja nga degradimi, qëndrimi në të mirë, dhe ecja drejt shtigjeve të mirësisë gjersa egoja të jetë e mposhtur e të mos shkaktojë daljen në pah e të keqes, janë tre elementë thelbësorë. Kështu, njeriu, mes këtyre tre elementeve orvatet me zikzaket e jetës së tij gjersa të gjejë një vend paqeje, o do anojë nga e mira, ose ruan Zot, nga e keqja. Për këtë arsye, gjërat në këtë botë nuk janë aq të thjeshta, dhe Urtësia e Zotit që është Hakim, Alim, Rahim, Kadir, ka vënë disa sprova e vështirësi që të mund të pastrojë të këqijat që bëjnë njerëzit, t'i forcojë vullnetet e tyre, t'u tregojë dobësitë e nefseve, përkohshmërinë e jetës, t'i nxisë për tek e mira dhe t'ua lëkundë ndërgjegjet që të lthehen kur janë në udhë të gabuar...

Në suren Sexhde, fjalët e Allahut janë aq të qarta për sa i përket përfundimit dhe se si njerëzit duhen të jenë të kujdesur në zgjedhjet që bëjnë, në rrugët që zgjedhin të ecin si dhe tregohet edhe mëshira e Zotit që fshihet në disa sprova e mundime që në dukje janë dënime, por në të vërtetë ato duhen parë si kamxhikë mëshire që paralajmërojnë dhe tërheqin vërejtjen e njerëzve kur janë mes të këqijave dhe në të gabuar:

وَلَنَذِيقَنَّهُمْ مِنَ الْعَذَابِ الْأَدْنَى دُونَ الْعَذَابِ الْأَكْبَرِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ

"E Ne do të bëjmë që ata të shijojnë një herë disa dënime të lehta, para se të bjerë ë drejta mbi ta që të dënohen me dënim të madh, me shpresën se ata do të kthejnë..."⁵

Urtësitë e vështirësive

Për një vështirësi që të ra, për një të keqe që të gjeti, një lodhje a një sëmundje, një humbje a një pësëm, një ndarje a një brengë, një shtrëngim a një rënie, një rrëzim a një plagë që more, një fatkeqësi a një pakësim që të kaploi, si pasojë e gabimeve dhe gjynaheve që vullneti yt i trazoi, mos u largo nga dera e Zotit. Si mund të mendosh keq për Të?! Kthehu dhe mendo rreth pasojave të zgjedhjeve që ke bërë dhe dije se nefsi yt që

5. Kur'an, Sexhde, 32:21.

ai që të urdhëroi drejt atyre të këqijave, e ti nuk e vure re se ai nefsi, pati aleancë me shejtanin dhe gafletin e dynjasë. Mos u merr me dynjanë, mos humb në të, mos ja vër veshin shejtanit, ai qe i dëshpëruar për vete! Mos u revolto ndaj Zotit tënd të dashur! Dorëzohu, pra, ji muslim'an... Mos harro, në Kur'anin Famëlartë, Allahu na ka paralajmëruar në disa vende:

وَمَا أَصَابَكُمْ مِّنْ مُّصِيبَةٍ فَبِمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ
"E nuk ju vjen ndonjë fatkeqësi përveçse për shkak të asaj që vepruat (që ju kapi dora me vullnetin tuaj) e sërish Ai të shumtët i fall!"⁶

Transmetohet në disa vende si ether, një lutje e bërë nga Abasi r.a., xhaxhai i profetit Muhamed a.s. si dhe ng Aliu r.a.,:

اللهم إنه لم تنزل عقوبة إلا بذنب ولا تنكشف إلا بتوبة
"O Zoti im, nuk ka dënim që nuk ka zbritur si shkak i mëkatit dhe që nuk është ngritur (larguar) si shkak i pendimit!"⁷

Vështirësitë e lehtësimeve që kërkojmë
Lehtësimet e pritura janë të fshehura brenda vështirësive që vijnë. Urtësitë e vështirësive janë me mijëra, e pastrojnë njerinë, e lartësojnë, e pjekin, e filtrojnë së brendshmi, e lajnë, i tregojnë vendin, i tregojnë njeriut njerinë, i tregojnë njeriut Zotin, e ngjisin dhe e ngrenë tek dera e Krijuesit, drejt shtigjeve të Ahiretit deri në prani të Allahut të Lartësuar e të Dashur.

Kur njeriu lutet për diçka dhe Zoti i sjell sebeb, ai refuzon të pranojë vështirësitë që do të sjellin lehtësimet për të cilat ai është lutur. Çdo gjë vjen me një mundim. Në suren Inshirah, vështirësia përmendet bashkë me lehtësimin. Duhet të kryesh punën një herë, që të paguhesh, nuk ka

6. Kur'an, Shura, 42:30.

7. Lutja transmetohet në vëllimet e Imam Ahmedit dhe Tirmidhiut.

gjë pa djesë. Kjo është dynjaja e sporvave. Janë sprovuar më të mirët. Merre sprovën si mirësi dhe tejkalojë me ndihmën e Zotit, duke iu mbështetur Atij plotësisht. Nëse mirësitë vijnë pa sebebe dhe drejtpërdrejt (gjë që është e mundshme, ngaqë Zoti është i plotfuqishëm për çdo gjë), janë drejtpërfrejt fitne-sprovë, sepse shpesh, nefsi është mosmirënjohës i lehtësimeve që i vijnë pa metodologjinë e përshkallëzuar të edukimit që sjellin sprovat dhe vështirësitë. Andaj edhe janë quajtur 'istidraxh', pra rrjedhja e mirësisë beftas dhe pa meritë e sebeb të arsyeshëm.

Lidhur me këtë ajetet kuranore janë të shumta. Një njeri i urtë e ka përmbledhur këtë gjë në një thënie jashtëzakonisht të thukët, duke thënë: "Ti refuzon të pranosh vështirësitë e lehtësive për të cilat je lutur!"

Le ta përmbyllim me një paragraf nga Abdulkadir Gejlani:

"Kërko mirësinë – afijetin në fe, në dynja dhe në ahiret e kjo të mjafton. Allahu nuk mund të detyrohet për asgjë. Ai bën vetëm atë që dëshiron në sundimin e Tij. Konsiderojë Zotin si Pronar. Ky Pronar është i mirë. Mos zgjidh asnjë tjetër. Nuk do të ishte mirë për ty. Kur ngren një barrë të rëndë, mos shih vetëm forcën tënde. Ndieje fuqinë e Zotit. Çfarë vlere do të kishin rinia dhe forca jote, pa fuqinë e Tij? Mos u mbështet shumë në pasurinë që ke. Çfarë mund të bëjë pasuria për ty? Pa ndikimin metafizik të Allahut, pasuria nuk ka vlerë. Kur Allahu të kap, Ai nuk të lëshon më. Harroji dëshirat; ji pak më shpirtëror. Mbrojtja e Tij vjen përmes mjeteve shpirtërore (metafizike). Masat materiale kanë shumë pak efekt. Edhe në rastin më të mirë, në ndodhtë të kenë, ndodh vetëm përmes ndikimit dhe lejes së Tij."⁸

8. Abdulkadir Gejlani, Fethu'r-Rabbani, Mexhlisi nr. 3, fq. 35.

EGOJA **KY ARMIK** **I NJERIUT**



Njeriu është krijesa më e bukur të cilin Allahu i madhërishëm e krijoi. Atë e pajisi me vlerat më të larta duke e dalluar nga të gjitha krijesat tjera. Kurani në shumë vende tregon vlerën që ka njeriu në këtë gjithësi si dhe rolin që pranoi nga Krijuesi i tij.

Megjithatë përkundër vlerave që njeriu posedon në vetën e tij, ai vazhdimisht zhgënjën me veprimet e tij për shkak të mbështetjes së shumë veprimeve në një gjë që quhet ego, të cilën djalli i mallkuar e shfaq në momentin që pa njeriun që përveç saj kishte edhe një gjë të bukur që quhej ndërgjegje.

Momentet e kësaj ngjarjeje i sjell në pah Kurani, që për herë të parë shpërthen diçka që nuk kishte qenë prezentë deri në ato momente.

(All-llahu) tha: **“Çka të pengoi ty të bësh sexhde, kur Unë të urdhërova?” Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i vlershëm se ai, më krijove mua nga zjarri, e atë e krijove nga balta!” (Araf, 12)**

Në ekzistencë del në skenë zëri i parë kundërshtues karshi Krijuesit, pikërisht duke u bazuar në një gjë që quhej ego. Thënë ndryshe fara e cila ishte e fshehur në krijimtarinë e Iblisit, tashmë kishte shpërthyer dhe do të vazhdojë si e tillë deri në ditën e Kijametit.

Por çfarë është në fakt egoja?

Në praktikë; të dhënit e tepruar pas vetvetes, pas interesave të tyre; sjellja dhe veprimtaria e njeriut që nuk tregon kurrfarë interesimi, kurrfarë kujdesi për interesat, vlerat dhe nevojat e të tjerëve, ndërsa në teori; pikëpamja, sipas të cilës interesat dhe nevojat e të tjerëve duhet t'u nënshtrihen me çdo kusht interesave të mia.

Ndoshta është një gjë në brendësinë tonë që mund të konsiderohet prej sekreteve tona të brendshme që as ne

të mos e kuptojmë. Prandaj i Dërguari i Allahut na mësonte lutjen:

“O Zot! Dua prej Teje të më bësh të mundur një ego që të beson Ty, që beson se do të rikthehet tek Ti, që është përherë e kënaqur me vendimet e Tua, e që di të mjaftohet me mirësitë e Tua dhe që ka arritur besimin në Ty!”

Ndërsa Kurani pasqyron gjendjen e rëndë të Jusufit a.s. në luftën e tij kundër egos derisa thoshte: **“Unë nuk e shfaqësoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që ka mëshiruar Zoti im, se Zoti im është që fal e mëshiron shumë.” (Jusuf, 53)**

Në realitet me që njeriu dallon nga krijesat tjera, atij i duhet që vazhdimisht të jetë në betejë me egon e tij dhe të dal fitimtarë karshi kërkesave të tij të pafund.

Dallimi qëndron krejt diku tjetër. Nëse shikojmë kafshët do të vërejmë se ato kanë ego, por nuk kanë mendje dhe vullnet. Dhe meqenëse nuk kanë mendje dhe vullnet atëherë nuk ndjenjë përgjegjësi për veprimet e tyre.

Tek engjëjt çështja qëndron ndryshe, ata kanë mendje por nuk kanë ego.

Problematika qëndron tek krijesat njeri dhe xhind. Atyre iu dhurua mendja, vullneti dhe egoja. Natyrisht atyre u takon të shqetësohen për zgjedhjet që do bëjnë në jetë, sepse do japin përgjegjësi për veprimet e tyre në këtë botë. Ata ose do të ecin me egon që do t'i shpi në humbje, ose me ndërgjegje e cila gjithmonë e ruan atë nga të vepruarit sipas natyrës së bukur njerëzore.

Si rrjedhojë, nëse njeriu nuk ecën i vendosur në rrugën në të cilën është duke ecur, duke mos i përgatitur të gjitha pajisjet e tij për një ecje në këtë rrugë; nëse nuk gjendet gjithnjë në përpjekje të vullnetshme për ta përmirësuar dhe rifreskuar veten e tij doemos një ditë do ta gjejë atë të robëruar karshi egos së tij.

01 DIPLOMOHET BREZI I KATËRT I STUDENTËVE TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE ISLAME "HAFIZ SABRI KOÇI"



U zhvillua këtë fundjavë në ambientet e Kolegjit Universitar "Bedër", ceremonia e diplomimit të brezit të katër të studentëve të programit një vjeçar për formim të përgjithshëm fetar.

Në vitin e tij të katër të aktivitetit, Instituti i Studimeve Islame "Hafiz Sabri Koçi", diplomoi 32 studentë, meshkuj dhe femra.

Në këtë ceremoni, morën pjesë: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkrjetari Taulant Bica, i cili është njëkohësisht përgjegjësi i mbarëvajtjes së këtij instituti, Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar "Bedër", Xhemal Saferti, si dhe myftinjtë, imamë, pedagogë dhe studentët që u bënë pjesë e këtij trajnimit përgjatë gjithë vitit që lamë pas.

Ky trajnim synoi t'u ofronte studentëve njohuritë bazë fetare në lëndët: Kuran, Hadith, Tefsir, Fikh, Akaid, Histori Islame, etj.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu, pasi uroi studentët për përfundimin me sukses të këtij programi, bëri një rezymë të shkurtër të rrugëtimit 4-vjeçar të institutit dhe efektit pozitiv që ka pasur ky i fundit në plotësimin e nevojave të KMSH-së me kuadro në terren.

Studentët i përshëndeti gjithashtu edhe Nënkrjetari Bica, i cili shprehu vlerësim të lartë për ta dhe ju uroi atyre suksese në praktikimin e këtyre dijeve të marra përgjatë gjithë trajnimit. Në cilësinë e Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Islame në Kolegjin Universitar "Bedër", Dr. Xhemal Saferti, në fjalën e tij u ndal në rëndësinë e shpërndarjes në mënyrë sa më të pastër e të drejtë të mesazhit universal të Islamit tek besimtarët dhe shoqëria mbarë. Më tej studentët e diplomuar nga ky vit u pajisën me certifikatat përkatëse.



02 REKTORËT E UNIVERSITETEVE SAUDITE NDEROJNË KRYETARIN SPAHIU PËR KONTRIBUTIN E TIJ



Ministria e Arsimit pranë Mbretërisë së Arabisë Saudite, në bashkëpunim me disa nga universitetet më prestigjioze të vendit, organizoi në Tiranë Forumin e Parë të të Diplomuarve nga Ballkani Perëndimor.

Aktiviteti u zhvillua nga 7 deri më 9 korrik dhe mbledhi së bashku qindra pjesëmarrës nga rajoni, përfshirë këtu përfaqësues të lartë të sferës akademike dhe asaj diplomatike.

Ndër të pranishmit e shumë të qm morën pjesë, ishin: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Faisal Gazi Hifdhi, ambasadorët e vendeve mike si: Katar, Kuvajti, Libia dhe Palestina, si dhe rektorët e universiteteve organizatore, të tillë si: Universiteti "Imam Muhamed bin Saud" i Riadit, Universiteti Islamik i Medinës dhe Universiteti "Umm al Qura" i Mekës.

Në fjalët e tyre përshëndetëse, të ftuarit e nderit e cilësuan Forumin si një platformë strategjike për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Arabisë Saudite dhe vendeve të Ballkanit, ndërsa të diplomuarit u vlerësuan si ura lidhëse mes kulturave dhe ambasadorë të vlerave islame.

Në kuadër të këtij forumi mjaft domethënës, rektorët e universiteteve organizatore i dorëzuan një plaketë mirënjohjeje kryetarit Spahiu, në shenjë respekti për kontributin dhe bashkëpunimin e tij ndër vite.

Ky Forum shënon një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të bashkëpunimit arsimor dhe kulturor mes Arabisë Saudite dhe Ballkanit, përmes rrjetëzimit të të diplomuarve si faktorë të dialogut dhe zhvillimit të qëndrueshëm.



03 KRYETARI SPAHIU PRET AMBASADOREN E ALGJERISË NË KMSH



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në ambientet e institucionit Ambasadoren e Algjerisë në Republikën e Greqisë, njëkohësisht e akredituar edhe për Shqipërinë, znj. Zaina Benhabouche.

Pasi i shprehu mirëseardhjen në selinë e institucionit, kryetari Spahiu vlerësoi kontributin e rëndësishëm të Algjerisë në promovimin e vlerave islame dhe mbështetjen ndaj nismave për forcimin e dialogut ndërfetar dhe bashkëpunimit kulturor. Më tej, ai e njohu Ambasadoren me organikën e institucionit, myftinitë në rrethe dhe institucionet në varësi.

Ndërsa Ambasadorja Benhabouche shprehu mirënjohjen e saj për këtë pritje dhe theksoi rëndësinë që Algjeria i kushton marrëdhënieve me Shqipërinë, duke vlerësuar rolin konstruktiv të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në promovimin e paqes, tolerancës dhe harmonisë ndërfetare.

Më tej, palët shprehën gatishmërinë për të intensifikuar më tej bashkëpunimin në fusha të ndryshme me interes të përbashkët, përmes shkëmbimeve kulturore, edukative dhe atyre fetare.

Gjatë kësaj vizite, Ambasadorja ishte e shoqëruar nga e Ngarkuara me Punë e Misionit Diplomatik të Algjerisë në Tiranë, znj. Nadia Lamrani, ndërsa kryetari Spahiu u shoqërua nga këshilltari i tij për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti, si dhe nga Myftiu i Krujës, z. Ermir Gjana.



04 AMBASADORI I AMBASADËS SË SHTETIT TË PALESTINËS NË VENDIN TONË VIZITON KMSH-NË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti sot në një takim kortezie, në selinë e institucionit, Ambasadorin e Ambasadës së Shtetit të Palestinës në vendin tonë, z. Sami Mehna.

Pas urimit të mirëseardhjes, kryetari Spahiu, e njohu shkurtimisht z. Mehna me institucionin që ai drejton, duke i prezantuar veprimtarinë e tij fetare, arsimore dhe ato sociale.

Ambasadori Mehna, e falenderoi kryetarin Spahiu për mikpritjen dhe vlerësoi rolin e rëndësishëm që ky institucion luan në promovimin e vlerave fetare, edukative dhe shoqërore në vend. Më tej, ai shprehu vullnetin dhe angazhimin e tij të plotë në forcimin e marrëdhënieve institucionale dhe intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me KMSH-në.

Gjatë takimit u trajtuan çështje të ndryshme të aktualitetit në Lindjen e Mesme, si dhe u diskutuan tema me interes të përbashkët, me theks të veçantë tek nxitja e dialogut dhe mirëkuptimit ndërmjet popujve.

Lusim Allahun Fuqiplotë që të përhapë paqen dhe qëndrueshmërinë në çdo cep të botës, veçanërisht aty ku mbizotërojnë konfliktet, të lehtësojë vuajtjet e të pafajshmëve dhe të udhëzojë shoqëritë njerëzore drejt mirëkuptimit dhe bashkëjetesës.

Gjatë këtij takimi, kryetari Spahiu shoqërohej nga këshilltari i tij për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti dhe Myftiu i Krijës, z. Ermir Gjana.



05 XHAMIA E RE E LIBRAZHBIT MIRËPRET BESIMTARËT PËR XHUMANË E PARË



Në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, këtë të premte u fal xhumaja e parë në xhaminë e re të qytetit të Librazhdit, një objekt kulturi modern i ndërtuar "Qatar Charity Albania".

Programi nisi me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Librazhdit, z. Edmond Ceni, i cili shprehu mirënjohjen e tij të thellë për donatorët dhe të gjithë kontribuesit që bënë të mundur ndërtimin e kësaj xhamie kaq të domosdoshme për qytetin.

Më tej, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mbajti hutben e kësaj dite të begatë, hutbe në të cilën shprehu mirënjohje të thellë për të gjithë ata që me përkushtim, mund dhe zemërgjerësi kontribuan në realizimin e kësaj veprë të ndritur, e cila do t'u shërbejë brezave si një qendër adhurimi, edukimi dhe udhëzimi shpirtëror.

Referimin e tij ai e bazoi në dy ajete të Kuranit Famëlartë, ajete të cilat theksojnë vlerën e veçantë të shtëpive të Allahut në tokë, duke vënë theksin mbi rëndësinë e ndërtimit, mirëmbajtjes dhe frekuentimit të xhamive.

Kujtojmë se më herët, vazën e xhumasë e mbajti nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, i cili ndau mesazhe të ndryshme vëllazërie, bashkimi dhe devotshmërie, ndërsa besimtarët e pranishëm i përshëndeti gjithashtu dhe ish-myftiu i Librazhdit, z. Ardit Hoxhllaku.

I pranishëm në faljen e xhumasë së parë në xhaminë e re të qytetit ishte edhe Drejtori i Qatar Charity Albania, z. Mahmud Abas Shakir.

Allahu (xh.sh) e bëftë këtë xhami burim hajri për qytetin e Librazhdit dhe një udhëzim për të gjitha zemrat që kërkojnë dritën dhe mëshirën e Tij.



06 KRYETARI SPAHIU PRET NË KMSH KREUN E UNIONIT TË BASHKËSIVE ISLAME SHQIPTARE NË GJERMANI



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit z. Mensur Halili, Kryetar i Unionit të Bashkësive Islame Shqiptare në Gjermani.

Kryetari Spahiu i shprehu mirënjohjen e tij z. Halili për vizitën dhe vlerësoi kontributin e këtij të fundit në promovimin e vlerave tona fetare dhe atyre kombëtare në Gjermani.

Ndërsa z. Halili vlerësoi punën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe rëndësinë e tij, jo vetëm për jetën fetare dhe organizimin e saj brenda vendit, por edhe si shembull i shkëlqyer për komunitetin shqiptar që jeton e punon në diasporë.

Gjatë takimit u bisedua mbi bashkëpunimet e mëparshme dhe mundësitë e avancimit të partneritetit në fushën e përçimit të mesazhit islam, si dhe në organizimin e jetës fetare të diasporës shqiptare në këtë vend mik.

Në përmbyllje të takimit, u shkëmbyen dhurata simbolike si shenjë respekti dhe bashkëpunimi të frytshëm.

Gjatë këtij takimi, kryetari Spahiu shoqërohej nga Nënkryetari i KMSH-së z. Lauren Luli dhe Drejtori i Kabinetit z. Aurel Çani.



Përrenjtë e vegjël

Cilado qenie njerëzore vjen në ekzistencë me potencial të caktuar të cilin duhet ta zbulojë dhe realizojë përgjatë ekzistencës së tij. Përderisa cilado qenie njerëzore vjen në ekzistencë me potencial të paracaktuar, autenticiteti dhe origjinaliteti janë bashkudhëtarë të pandarë të njeriut përgjatë përkohësisë. Kësisoj as nuk ka patur dhe as nuk mund që të ketë një ekzistencë të ngjashme me ekzistencën tonë si qenie njerëzore krejtësisht të veçanta. Kjo do të thotë që pabarazia është prej rendit natyror të realitetit me të cilin dhe në të cilin jetojmë. Hierarkia është rregulli që mbizotëron kaudo. Njerëzit nuk mund të pajisen me të njëjtin potencial, për rrjedhojë edhe zbulimi e realizimi i këtij potenciali ndryshon nga njëra qenie njerëzore tek tjetra. Kjo pabarazi dhe ky diferencim i qartë në potencialin e gjithsecilit, është një nga bukuritë më të mëdha të jetës. Në sajë të këtij ndryshimi njerëzit bëhen të nevojshëm për njëri – tjetrin. Askush nuk mund të jetë një Robinson Kruzo përgjatë gjithë jetës. Njeriut i duhet të hyjë dhe të krijojë raporte me të ngjashmit e tij, por jo vetëm kaq. Ai duhet të hyjë dhe të krijojë raporte edhe me botën që e rrethon. Raportet që krijon njeriu me realitetin lëndor të botës, nuk paraqiten problematike, përderisa njeriu të mos ketë cenuar ekuilibrat mbi të cilët qëndron dhe jeton kjo botë. Ndërkohë raportet me të ngjashmit e tij, janë gjithmonë të paparashikueshme, sepse i tillë është edhe vetë njeriu, i paparashikueshëm. Gjendja e njeriut nuk është aspak konstante, madje konstantja në jetën e njeriut është tërësisht e përgjatshme dhe e papranueshme. Jeta e tij është rrjedhje e lëvizshmërisë ndërmjet gjendjeve dhe situatave nga më të ndryshmet, shpeshherë surprizuese, madje aspak të pritshme nga përlogaritjet njerëzore. Kjo larushi, shumëngjyrësi dhe shumëllojshmëri ngjarjesh dhe situatash na vendos përballë sfidës së vendimmarrjes, mbi mënyrën sesi do të drejtojmë anijen tonë në tallazet e lëvizshmërisë, ashtu sikundërse timonieri - kapiten drejton anijen në oqeanin e pamatë. Vendimmarrja duket të jetë më e thjeshtë dhe më pak kokëçarëse kur ka të bëjë me veprime pasojat e të cilëve bien drejtpërsëdrejti mbi vendimmarrësin dhe jo edhe mbi të tjerët. Natyrisht që çështja bëhet më e komplikueshme dhe në fakt e tillë është, kur njeriut i duhet të marrë vendime të cilat, nuk kanë impakt vetëm mbi të por edhe mbi numër tjetër njerëzish, përderisa nuk është një Robinson Kruzo. Njerëzit hyjnë në raporte me njëri – tjetrin, për arsye dhe

qëllime nga më të ndryshmet, për të realizuar potencialin e tyre përgjatë jetësimit të mënyrës së jetesës. Një pjesë i përbashkon interesi material dhe përplotësimi i tij, e një pjesë i përbashkon parimet e epërme, që i tejkalojnë ato materiale, jo për t'i lënë në harresë, por për t'iu dhënë vendin që meritojnë në hierarkinë e vlerave që duhet të realizojë njeriu në përputhje me parimet e epërme. Marrëdhëniet e ngritura mbi interesa materiale, janë të qëndrueshme për aq sa interesi i palëve të përfshira nuk është cenuar apo dëmtuar, në të kundërt raportet mund të përmbysen dhe mund të riformatohen apo të humbin krejtësisht. Ndërkohë ata të cilët janë apo pretendojnë të jenë të përkapur pas parimeve të epërme, parimisht janë përbashkuar mbi një bazament që nuk është aspak njerëzor edhe pse për natyrën njerëzore është udhërrëfyes i rrugëtimit përkohësor. Meqenëse qeniet njerëzore në përputhje me rendin natyror të krijimit, janë pajisur me potenciale të ndryshme, edhe kuptimi dhe interpretimi i parimeve të epërme do të jetë përputhshmërisht me potencialitetin që iu është dhënë, dhe për këtë askush nuk duhet të ndihet në pozicion të vështirë dhe të sikletshëm, sepse çdokush nuk mund të realizojë më shumë sesa i është paracaktuar të realizojë. Edhe pse të përkapur pas parimeve të epërme, sërishmi nuk mund të dorëhiqen nga përplotësimi i dimensionit material, në të kundërt do të vepronin në kundërshtim me natyrshmërinë e rendit natyror të gjërave. Në këtë përpjekje, që nuk mund të shuhet vetëm se me daljen e njeriut nga përkohësia, çdocili përpiqet të realizojë potencialin e dhënë dhe të sigurojë mjetet e nevojshme për jetesë, për vete dhe për ata që ka nën përgjegjësi. Edhe kjo përpjekje është tërësisht legjitime madje edhe e urdhëruar, pasi njeriu nuk mund të shmangë përgjegjësitë që ka ndaj vetes dhe atyre nën përkujdesjen e tij. Në rrjedhën e këtyre përpjekjeve njeriu përpiqet të gjejë apo të sigurojë një punësim, i cili mund edhe të mos jetë meritokratik, porse i ndihur nga konjunkturat e kohës dhe momentit ai mund ta shohë veten aty ku edhe në ëndërr nuk e kishte parë. Duke qenë se njerëzit janë të natyrave të ndryshme, edhe edukimi është i ndryshëm, intelijenca dhe kuptimësia është e ndryshme, aftësitë dhe profesionalizmi janë të ndryshme, mënyra e realizimit të modus vivendi është e ndryshme edhe pse përbashkohen tek parimet e epërme. Kësisoj ushtrimi i një detyre të caktuar, nëpërmjet një pozite të caktuar është e varur kryekëput

nga cilësia e edukimit, inteligjencës, profesionalizmit. Ndryshueshmëria e pozicionon njeriun në pozita të ndryshme në hierarkinë e profesioneve. Dikush mund të posedojë më shumë mundësi financiare se një tjetër, dikush mund të jetë më materialisht më mirë se një tjetër, dikush mund të jetë në një pozitë më të lartë sesa një tjetër, dikush mund të katapultohet në një pozitë më të lartë sesa një tjetër. Të qenurit në pozita të ndryshme jo vetëm që të jep kënaqësinë e realizimit të potencialit dhe sigurimit të të ardhurave për të përballuar jetesën, por njëkohësisht të vendos përballë një sfide të vështirë sidomos kur je i vendosur apo i katapultuar në pozita drejtuese. Njeriu nuk është në provë vetëm kur përjeton vështirësi, por ndoshta është më në provë kur i jepet mundësia për të marrë në dorë drejtimin e të tjerëve. Katapultimi në pozita drejtuese është ndoshta një nga sfidat më të vështira për njeriun, sepse ose do të tregojë fytyrën e vërtetë të këtij njeriu, ose mund ta transformojë në një podium arrogancë dhe shpërfillje ndaj atyre që drejton, pasi që njerëzit mund t'i shfaqen përmes mirazhit të postit si gurë shahu që mund t'i lëvizë sipas dëshirës, duke harruar se lëvizjet jo të duhura mund ta çojnë drejt shah-mat. Natyrisht që jo të gjithë thyhen përballë kësaj sfide torturuese, pasi që për çdokënd sfidat nuk janë kurrsesi të njëjta, ashtu siç nuk është e njëjtë edhe forca kundërvepruese për t'i rezistuar sfidave.

Fjala e urtë thotë se miku i mirë njihet në ditë të vështira. Njeriu nuk mund të ketë askënd mik më të mirë sesa vetveten. Dhe ky mik do të njihet në ditë të vështira dhe nuk ka ditë më të vështira për njeriun sesa kur merr mbi shpatulla përgjegjësinë e drejtimit të një anijeje. Më sipër theksuam se ajo çfarë i përbashkon një pjesë njerëzish, janë parimet e epërme, universale dhe të mbarëkohëshme. Përbashkimi përreth parimeve të epërme nuk nënkupton domosdoshmërisht unifikimin dhe standardizimin e gjithësa përpiken për të qenë të përbashkuar, përkundrazi. Unifikimi dhe standardizimi i të përkapurve është kryekëput i pamundur dhe nuk është prej natyrshmërisë së parimeve të epërme që të kërkojnë prej njeriut jetësimin e pamundshmërisë. Në qoftë se parimet e epërme janë kuptuar në natyrën e tyre të njëmendtë, nuk mund t'i përbashkosh të përkapurit përmes diktatit të çfarëdo instrumenti. Përbashkimi është pasojë e besimit dhe bindjes ndaj vetë parimeve të epërme, për të ndihur njëri – tjetrin në rrugëtimin e rikthimit në banesën tonë të parëhershme, pavarësisht ndryshueshmërisë dhe dallimeve. Diktati është instrument i papranueshëm për parimet e epërme në sjelljen ndaj njerëzve, sepse diktati nuk mund të ofrojë dashuri, harmoni dhe tolerancë përmes ashpërsisë dhe intolerancës, anatemimit dhe përjashtimit të atij që mendon ndryshe nga pozita e zbatuesit të diktatit. Diktati në sjelljen me njerëzit nuk mund të sjellë frytet që synon, sepse çdokush që ndjen forcën e diktatit do

të rebelohet ndaj tij dhe këtë të fundit do ta kryejnë ata të cilët nuk njohin dhe pranojnë autoritet dhe pushtet tjetër, përveç autoritetit dhe pushtetit të së Vërtetës. Në qoftë se ndokush është katapultuar për shkak të konjunkturave, kjo nuk presupozon dhe as që mund të jetë një arsye e mjaftueshme për kacagjelosje, por përrënjtë e vegjël fryhen shpejt. Në ditë shtrëngatash, me re të dendura kur bie shi me gjyma përrënjtë e vegjël fryhen, egërsohen dhe janë gati të marrin përpara dhe ta përfundin çdo gjë që guxon të pengojë rrjedhën e tyre të furishme. Në këto momente zhurma dhe uturima e tyre mbytëse ndihen larg. Por drita e diellit shkëlqen përsëri dhe ata kthehen sërish në shtratin e tyre të ngushtë, të zalisur e të molepsur për të mos iu ndierë asnjë lloj zhurme. Me tërheqjen në shtratin e tyre të ngushtë, zbulojnë pasojat e fryrjes dhe egërsimit të tyre ndaj jetës, e cila do t'i gëzohet sërishmi dritës së diellit. Kësisoj diktati nuk të çon askund përveçse në prehrin e konfliktualitetit dhe urrejtjes ndërmjet vetë të përkapurve pas parimeve të epërme, ndërkohë që ajo që i përbashkon qëndron ku e ku më lart nga ajo që i ndan. Po përse veprohet kështu, kur mund të veprohet ndryshe dhe më pranë natyrshmërisë së parimeve të epërme? Sepse gjithmonë do të jenë dy grupe njerëzish të cilët janë prezent si tek ata që janë përbashkuar rreth interesit material, ashtu edhe tek ata të cilët janë përbashkuar përreth parimeve të epërme, vartësit dhe heretikët.

Ka një lloj njerëzish që adhurojnë (përnderojnë, N.N) pushtetin e fortë, dëshirojnë të jenë të shtrënguar, i mrekullon rendi, ai i jashtmi, siç është në ushtri, "ku dihet kush komandon e kush dëgjon". Shija e tyre përkon me pjesët e reja të qytetit, tek janë identike të gjitha shtëpitë, në rreshta të drejtë dhe me fasada identike. Ata prapë pëlqejnë llamarinën – muzikën, uniformën, spektaklin, paradat dhe gënjeshttrat e tjera që "zbukurojnë" jetën dhe e lehtësojnë. Veçan dëshirojnë që të jetë "çdo gjë sipas ligjit". Këta janë njerëzit me mentalitet vartësie. Ata kanë dëshirë të jenë vartës, kanë dëshirë sigurinë, rendin, stabilizimin, kanë dëshirë të lavdërohen nga eprorët e vet, kanë dëshirë të jenë "në mëshirë". Ata janë të ndershëm, lojalë, për më tepër – qytetarë korrektë. Vartësit dëshirojnë të ketë pushtet, kurse pushteti dëshiron të ketë vartës. Ata shkojnë së bashku si pjesë e një tërësie. Po s'pati autoritet, vartësit e shpikin. Në anën tjetër qëndron një lloj i pafat, i mallkuar njerëzish që kundërshton vazhdimisht për diçka, që kërkon vazhdimisht diç të re. Ai për bukë flet më pak, kurse për liri më shumë, më pak për rendin dhe qetësinë, kurse më shumë për personalitetin e njeriut...Këta heretikë të amshueshëm zakonisht nuk e duan pushtetin, as pushteti s'i do ata. Kur janë religjiozë, vartësit adhurojnë (përnderojnë, N.N) njerëzit, autoritetet, idhujt; njerëzit e lirë dhe kryengritësit adhurojnë Zotin e vetëm.

SHKENCA E TASAVUFIT



Tasavufi është rruga e edukimit të shpirtit dhe të sjelljes, me anë të së cilës besimtari arrin gradën e mirësisë (ihsanit) të përshkruar në hadith si: “Ta adhurosh Allahun sikurse ti e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai sigurisht që të shikon ty”.

Tasavufi është një program edukimi, i cili synon pastrimin e egos (nefsit) nga të gjitha sëmudjet e saj, të cilat e mbajnë atë larg nga Krijuesi. Gjithashtu, me anë të kësaj rruge synohet rehabilitimi i të gjitha çrregullimeve të brendshme apo ato të sjelljes, të cilat kanë të bëjnë me marrëdhënien që njeriu ka me Allahun, njerëzit dhe veten e tij.

Rruga e Tasavufit mund të cilësohet si një medrese, ku përmbushet pastrimi i nefsit dhe formimi i sjelljeve të lavdëruara dhe në këtë pikë, mësuesi (shejhu) e drejton nxënësin (muridin) e tij.

Qenia njerëzore, për sa i përket natyrës së saj, vuan nga disa lloje sëmudjesh si mendjemadhësia, vetëpëlqimi, mashtrimi, koprracia, zemërimi, smira, etj. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

وَمَا أُنَبِّئُ نَفْسِي إِنَّ النَّفْسَ لَأَمَّارَةٌ بِالسُّوءِ إِلَّا مَا رَجِمَ رَبِّي إِنَّ رَبِّي غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im”. (Jusuf, 12/53)

Pikërisht nga kjo, të parët tanë kuptuan domosdoshmërinë e një metode për edukimin e nefsit, pastrimin e tij nga sëmundjet, në mënyrë që ai më pas të përzihet me shoqërinë dhe të gëzohet me ecjen drejt Zotit të tij.

Ruga e Tasavufit duhet të jetë e cilësuar me veçoritë e mëposhtme:

E para: Të qëndruarit besnik ndaj Kuranit dhe Sunetit. Pra, kjo është ruga e sufistëve dhe refuzohet çdo gjë që bie ndesh me këto dy burime.

E dyta: Kjo rrugë nuk llogaritet si një rrugë e ndarë për mësimin e Sheriatit, porse konsiderohet si thelbi i tij.

Tasavufi na shfaqet në tre pika kryesore, për të cilat na nxit edhe Kurani Famëlartë.

1- Dhënia rëndësi e përkujdesjes për nefs, vetëllogaria dhe pastrimi i tij prej papastërtive. Allahu thotë: **وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا (7) فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا (8) قَدْ أَفْلَحَ مَنْ (9) وَفَدَّ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا (9) وَفَدَّ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا** “Pasha shpirtin dhe Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen dhe të mirën. Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin (nefsin) do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë, do të dështojë.” (Shems, 91/7-10)

2- Shtimi i përmendjes së Allahut të Lartësuar. Ai thotë: **يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اذْكُرُوا اللَّهَ ذِكْرًا كَثِيرًا** “O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun”. (Ahzab, 33/41)

3- Asketizmi (zuhdi) në këtë botë, moslidhja fort pas saj dhe synimi i botës tjetër (ahiretit). Allahu thotë: **وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا لَعِبٌ وَلَهْوٌ وَلَلْآخِرَةُ خَيْرٌ لِلَّذِينَ يَتَّقُونَ أَفَلَا تَعْقِلُونَ** “Jeta e kësaj bote është vetëm lojë dhe argëtim, kurse bota tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që e frikësohen Allahut”. (En’am, 6/32)

Ishte prej udhëzimit të Profetit (a.s.), që ta këshillonte çdo njeri për tu afruar tek Allahu (xh.sh) në bazë të ndërtimit të ndryshëm të personalitetit të gjithsecilit. Vjen dikush dhe i thotë atij: “O i Dërguar i Allahut, më trego mua diçka që më largon nga zemërimi i Allahut.” Ai (a.s.) i tha: “Mos u zemëro!” Vjen dikush tjetër dhe i thotë: “Më thuaj diçka (një vepër) pas së cilës të përqendrohem fort”. Profeti (a.s.) e këshilloi duke i thënë: “Gjuha jote vazhdimisht të jetë e lagur me përmendjen e Allahut (xh.sh)”.

Kishte prej sahabëve nga ata që falnin shumë namaz nate, disa të tjerë lexonin shumë Kuran disa të tjerë bënin shumë dhikr dhe jepnin shumë lëmoshë. Kjo nuk do të thotë të braktisësh diçka prej adhurimeve, porse këtu bëhet fjalë për një adhurim të posaçëm, të cilin e praktikon shumë ai person, që është futur në rrugën për të mbërritur te Allahu i Lartësuar.

Për këtë arsye edhe Xheneti ka disa dyer, porse fundi i tyre të dërgon përsëri në të njëjtin vend. Profeti

(s.a.s.) thotë: “Për çdo grup njerëzish të veprave të mira ka një derë prej dyerve të Xhenetit, prej të cilës ata do të thirren. Për agjëruesit ka një derë që quhet Rejan.”

E njëjta situatë është edhe për rrugët e Tasavufit, në varësi të mësuesit apo nxënësit, ka prej tyre që i japin rëndësi agjërimit apo leximit të shumtë të Kuranit, porse ata nuk neglizhojnë veprat e tjera.

Këtu përmendëm Tasavufin e vërtetë, rrugën e tij të saktë, mësuesin e drejtë të kapur pas Kuranit dhe Sunetit dhe mësuar arsyen pse ekzistojnë shumë rrugë, si shkak i numrit të shumtë të metodave të edukimit dhe ndryshimit të rrugëve të mbërritjes te Zoti, porse ato bëhen një në qëllim, dhe ai është Allahu i Lartësuar.

Së fundmi i përgjigjemi atyre që thonë, pse nuk i mësojmë normat e sjelljes dhe pastrimin e nefsit direkt nga Kurani dhe Suneti? Kjo është një fjalë në dukje si mëshirë, por në kuptim si dënim, për arsye se ne nuk i kemi mësuar kushtet e namazit, sunetet e tij dhe gjërat e papëlqyeshme në të nëpërmjet leximit të Kuranit dhe Sunetit, por i mësuar të gjitha këto nga një shkencë e quajtur fikh (jurisprudencë islame), të cilën e formuan dijetarët e saj dhe deduktuan të gjitha këto dispozita nga burimet përkatëse.

Atëherë çfarë mbetet për dikë, që dëshiron ta mësojë fikhun dhe dispozitat e fesë direkt nga Kurani dhe Suneti, ndërkohë që nuk gjendet asnjë dijetar i cili pretendon ta mësojë fikhun direkt nga burimet e përmendura.

Gjithashtu, ka gjëra që nuk përmenden në Kuran dhe Sunet dhe ato duhen mësuar nga shejhu (mësuesi) përkatës dhe nga goja e tij dhe nuk është e drejtë, që për këto shkenca të themi se na mjafton Kurani dhe Suneti, siç është shembulli i shkencës së Texhvidit, në të cilën duhet të përdorim terminologjinë e saj specifike. P.sh.: “Medi لازم është 6 hareke”. Kush është ai që e quajti këtë zgjatje si të domosdoshme? Ata janë pra, dijetarët e kësaj shkence.

E njëjta gjë është edhe për shkencën e Tasavufit, shkencë të cilën e formuan dijetarët e saj që prej kohëve më të hershme, nga shekulli IV e deri në ditët tona. Në momentin kur u prishën kohërat, u prish edhe morali i njerëzve dhe kështu u prishën edhe disa nga rrugët e sufizmit dhe u lidhën pas gjërave të jashtme në kundërshtim me fenë e Allahut dhe kështu njerëzit menduan se ky ishte Tasavufi.

Shpresojmë të kemi sqaruar me ato që përmendëm kuptimin e Tasavufit, rrugën e tij, rolin e mësuesit të drejtë, arsyen e numrit të shumtë të rrugëve dhe pse ne i mësojmë normat e sjelljes dhe pastrimit të vetvetes nga kjo shkencë. E lusim Zotin të na japë të kuptuar të thellë ndaj çështjeve të fesë dhe Allahu është ai që çdo gjë e di më së miri.

Lërimi fëmijët ta jetojnë fëmijërinë



Mos i stresoni fëmijët tuaj dhe mos i fusni në depresion në emër të edukimit të fëmijëve perfektë.

Fëmijët e brezit të sotëm sillen si të mëdhenj por nuk duhet harruar fakti se ato akoma janë fëmijë dhe duhet ta jetojnë gjallërinë e fëmijërisë. Nëse nuk dëshironi të rrisni fëmijë të tensionuar dhe depresivë në emër të edukimit të fëmijëve perfektë, atëherë dëgjoni pak këshillat e specialistëve rreth kësaj teme. Fëmijët e sotëm po përjetojnë një fëmijëri krejt ndryshe me nëna dhe baballarë më të informuar dhe të arsimuar, me një zhvillim të paparë të teknologjisë dhe ndryshimin e strukturës sociale. Ato tani sillen si një "i rritur" i vogël me ndihmën e njohurive të marra, aftësive dhe fushave të interesit. Por, kjo situatë sjell me vete edhe sindromën e konsumimit, lodhjes kronike dhe ankesës nga depresioni.

Komentet më të përhapura të prindërve janë "ne bëjmë gjithçka që mund t'i pëlqejë çdo fëmije por ai nuk gëzohet", "e kemi kaluar të gjithë fundjavën duke vrapuar", "ndërkohë që unë pres mbarimin e orës së notit të të voglit, burri pret vajzën në kursin e pianos". Përballë tyre kemi komentet e fëmijëve "unë kalëroj nga mëngjesi deri në darkë, futem në kursin e violinës për t'u qetësuar dhe më pas në studim. Kam dhe një

kurs tjetër por nuk do të shkoj se kam provim. Nëse ndahem keq në provim mami do të nxehet shumë".

Këto fëmijë quhen ndryshe dhe fëmijë të nxituar. Ky koncept i zhvilluar nga psikologu amerikan, David Elkind, tregon se koha e fëmijëve planifikohet sipas preferencave të prindërve dhe ky plan paraqet më shumë mësim të shoqëruar me shumë aktivitete fizike, sociale, kulturore, të cilat ndihmojnë zhvillimin e fëmijës. Prindërit nuk ndihen mirë kur nuk zhvillohen këto aktivitete. Nëse këto prindër e konceptojnë rolin e prindit të mirë si të atij i cili edukon një fëmijë kampion në not, në gjimnastikë, fenomen në shkollë atëherë do të mbesin gjithmonë të pakënaqur. Kjo është dhe arsyeja e përpjekjes së tyre për të shtuar numrin e aktiviteteve. Dhe kështu në mendjet e tyre vendoset mendimi "unë duhet të bëj më të mirën për fëmijën tim dhe ai duhet të bëjë më të mirën".

Fëmijët ndihen të paafte

Të jesh fëmija i një prindi i cili mendon se "djali im duhet të dijë shumë gjuhë, duhet të jetë më i miri në piano, të bëjë më të mirën e tij" është pak e vështirë. Fëmijë të tillë ndihen të paafte përballë reagimeve të pakënaqura të prindërve, megjithëse



mund të japin maksimumin e tyre. Mesazhi i transmetuar nga prindërit i bën ato të ndihen të pavlerë dhe të pamjaftueshëm.

Fëmijët të cilët vrapojnë mes shkollës dhe kurseve private janë të detyruar të bëjnë pazarllëk me prindërit për sa i përket orarit të pushimit. Të sforcuar mbi kapacitetin e tyre fëmijët e tillë përjetojnë grindje në shkollë, janë të stresuar në provime dhe më pas kalojnë në depresion. Krahas kësaj duhet të nënvizohet fakti se viteve të fundit është rritur numri i fëmijëve të cilët ankohen nga lodhja kronike dhe sindroma e konsumimit. Dhimbjet e kokës, të barkut të lidhura me stresin shoqërohen më pas me mungesën e dëshirës për të shkuar në shkollë apo kurset jashtëshkollore.

Lëreni të jetojë fëmijërinë!

Fëmijët që sillen si të rritur dhe nuk zhvillohen nga ana emocionale, të rritur me psikologjinë e të nxituarit, përjetojnë frikë dhe stres më të madh gjatë provimeve. Kanë frikë nga dështimi. Në mendjen e tyre formohen mendime negative dhe shqetësuese në lidhje me provimin. Kur nuk marrin notën maksimale shqetësohen nga reagimet e prindërve të shoqëruara me fjalë si “ke mësuar pak, nuk ia dole, nuk ke

dhënë maksimumin”. Sipas studimeve të zhvilluara bëhet e ditur se njohuritë akademike nuk janë shkaktare të performancës së dobët por është mosvlerësimi i vetvetes dhe personalitetit.

Disa këshilla me anë të të cilave mund t’i largoni fëmijët nga psikologjia e të nxituarit dhe të parandaloni depresionin.

- motivojini fëmijët në bazë të aftësive dhe fushave të interesit. Në këtë mënyrë do të ndikoni pozitivisht në zhvillimin e tyre psiko-social. Por planifikimi i këtyre aktiviteteve nuk duhet të jetë mbi kapacitetin e fëmijës.

- lëreni të luajë lirshëm dhe të vërë në punë imagjinatën. Kjo i mundëson pavarësinë fëmijës dhe e bën të ndihet i sigurt. Fëmijët të cilët luajnë me lodra kanë mundësinë të njohin më mirë vetveten, kuptojnë mangësitë dhe nevojat e tyre dhe janë më të qetë në shprehjen e tyre.

- dëgjoni fëmijët. Jo vetëm fjalët që thonë por shikoni mire dhe formën e trupit, shprehjet e fytyrës, tonin e zërit.

- lëreni fëmijën të qetë nëse e shihni se po rri kot, pa bërë gjë, nëse shihni se është duke luajtur me peceta apo lexon një libër.

Le të vazhdojë të bëjë çfarë dëshiron. Në këtë mënyrë do ta lejoni të përjetojë fëmijërinë e tij brenda një dite të lodhshme.

Prefekti i parë i Mekës pas Islamit

Attab ibn Esidi (r.a.) ishte akoma një djalosh 11 ose 12 vjeçar kur Profeti (a.s.) emigroi nga Meka për në Medinen e bekuar. Që atëherë, i dërguari i Zotit e kishte kuptuar potencialin e tij dhe ishte ndikuar. Ndonëse kishte emigruar drejt Medines, Profeti e kishte ndjekur atë hap pas hapi në çdo aspekt. Edhe pse në atë shoqëri familjet ishin me shumë fëmijë, kjo gjë Profetit nuk ja kishte harruar fytyrën dhe emrin e tij.

Ndërkohë që pas shumë vitesh, kur bashkë me sahabët ishte drejtuar drejt Mekës për çlirimin e saj, ndër emra të tjerë që priste të pranonin Islamin, ai (a.s.) ia kishte përmendur atyre edhe Attab ibn Esidin (r.a.). Por edhe pse Meka ishte çliruar, Attabi nuk e kishte pranuar menjëherë Islamin. Ashtu si disa Mekas të tjerë, edhe ai kishte disa dyshime që e pengonin. Vendimin do e tregonte koha.

Tashmë kishte hyrë koha e drekës dhe Bilal Habeshiu, të cilin dje nuk donin ta shikonin, ngaqë ishte një skllav me ngjyrë, sot ishte ngjitur në majë të Qabes dhe po thërriste ezanin e parë në Mekë. Zëri i tij, që para disa vitesh kishte tronditur malet Faran me fjalët 'Ehad! Ehad!' nga torturat e Mekasve, sot po u dukej atyre si shigjetë vrastare. Sigurisht që kjo nuk u kishte pëlqyer!

Një grup njerëzish Mekas, duke dëgjuar ezanin e Bilalit, po e shprehnin këtë ndjenjë mospëlqimi me njëri-tjetrin. Midis tyre ishte edhe Attab ibn Esid. Madje, ai ishte i pari i cili mori fjalën duke nënkuptuar për të atin se "Allahu e ka begatuar Esidin (që ka vdekur) sepse sot nuk po e dëgjon këtë zë prej të cilit mund të çmendesh nga inati".

Vëllai i Ebu Xhehlit, Harith ibn Hishami dhe poeti i famshëm Suhejl ibn Amri, theksuan: "Nëse do të mendoja se ai (a.s.) ishte me të vërtetë, menjëherë do t'i besojat". Radhën për të folur e kishte Hakem ibn Ebī'el'Asi, i cili thotë: "Të hipë një skllav në majë të ndërtesës së Ebu Talhasë (Qabes) dhe të bërtasë në këtë mënyrë, me të vërtetë është një ngjarje e madhe!"

Ndërsa Ebu Sufjani, i cili po i dëgjonte me vëmendje, ishte më i rezervuar. Padyshim se poshtë këtij rezervimi qëndronte një përvojë e rëndësishme, sepse i dërguari i Allahut (a.s.) ia kishte vërtetuar atij më parë, se i dinte me imtësi të gjitha temat e diskutimit që ai bënte në shtëpi vetëm me gruan e tij, Hindin. Kështu që ai tha: "Në lidhje me këtë temë, unë nuk mund të them diçka, sepse e di që, sikur të them diçka, edhe këta gurë që janë këtu shkojnë dhe ia tregojnë atij se çfarë folëm!"



Pas pak, ndodhi ajo që kishte menduar Ebu Sufjani. Engjëlli Xhibril erdhi dhe ia tregoi atij (a.s) gjithçka që u fol në atë grup njerëzish. Pas kësaj, i dërguari i Allahut (a.s) shkoi midis tyre dhe tha: *"E di shumë mirë që ju folët mes jush kështu e kështu."*

Pas kësaj ngjarjeje, të gjithë ishin goditur aty ku nuk e prisnin. Edhe pse për pak minuta nuk mundën ta fshehin habinë, i pari që u dorëzua ishte Attab ibni Esidi, i cili menjëherë shprehu bindjen ndaj Profetit (a.s.) duke thënë: "Edhe ne dëshmojmë se me të vërtetë ti je i dërguari i Allahut! Nuk pati njeri që t'i dëgjonte fjalët tona dhe t'i tregonte ty!". Ja pra, më në fund, pas vitesh të tëra, erdhi momenti i shumëpritur dhe Attab ibni Esidi pranoi Islamit.

19 ditë pas kësaj ngjarjeje, i dërguari i Zotit (a.s.) bashkë me ushtrinë, u detyruan të niseshin drejt Hunejnit dhe personi të cilit i dorëzoi drejtimin e Mekës duke e bërë prefekt, ishte djaloshi 19 ose 20 vjeçar, i sapo bërë mysliman, Attab ibni Esidi (r.a.). Rasulullahu (a.s.) i kishte caktuar atij një rrogë prej 2 derhemësh. Në këtë detyrë, ai ka qenë aq shumë i kujdesshëm dhe i ndjeshëm, saqë ka thënë: "Qëkur jam emëruar në këtë detyrë, nuk kam përfutur diçka tjetër, veçse 2 rroba që ia kam veshur

ndihmësit tim Kejsan."

Ndërkohë që Rasulullahu (a.s.) përveç atij si prefekt, kishte emëruar edhe Muadh ibni Xhebelin dhe Ebu Musa el Eshariun (r.a.) si mësues në Mekë. As Ebu Sufjani dhe as persona të tjerë me pozitë nga Kurejshët, nuk e kishin parë si problem këtë lëvizje. Ndoshta, ata mund të kishin menduar se, në atë vend ku me pozitë drejtues mund të ishin këta njerëz të mëdhenj, si ka mundësi që djaloshi 20 vjeçar të na drejtojë neve! Por përkundrazi, pranimi i Islamit nga ana e Attab ibni Esidit dhe ndikimi i tij në jetët e kurejshitëve, i bëri ata t'i binden me modesti vendimit profetik. Edhe pasi profeti Muhamed (a.s) largohet nga Meka për tu kthyer në Medine, ata vazhduan t'i binden atij vendimi.

Ndërkohë, Attab ibni Esidi e vazhdoi detyrën e prefektit të Mekës edhe nën drejtimin e Ebu Bekrit (r.a.). Mirëpo Attabi (r.a.) nuk jetoi gjatë dhe në një moshë fare të re, 23 ose 24 vjeçare, u largua nga kjo botë. Pikërisht, po në atë ditë ndërron jetë edhe kalifi i parë i profetit, Ebu Bekri (r.a.). Pa harruar të theksojmë se Attabi njëkohësisht ishte edhe dhëndërr i Ebu Xhehlit.

Besnikëria

është cilësi e besimtarit

Duke njoftuar për kohën e fundit, profeti Muhamed (a.s.) thotë: *"Tradhtarët do të quhen të besueshëm, njerëzit e besueshëm do të quhen tradhtarë dhe, numri i njerëzve të besueshëm do të ulet deri në atë pikë sa do të thuhet: Ka një person të besueshëm atje."*

Besnikëria në Islam, ka lidhje me koncepte fetare si sinqeriteti, drejtësia, përgjegjshmëria, mbajtja e fjalës së dhënë, çuarja në vend e amanetit, durimi, qëndrueshmëria, pendesa etj. Kurse e kundërta e saj janë konceptet e lidhura ngushtë me mashtrimin, tradhtinë, dyfytirësinë, mosmirënjohjen e të tjera të ngjashme. Lidhur me njerëzit e besës, Allahu në Kur'an urdhëron e thotë: **"Këta janë ata që e zbatojnë besën e dhënë Allahut dhe nuk e shkelin premtimin."**¹

Njeriu i besës është ai që zbaton pa mungesa detyrimet që ka në marrëdhënie me Zotin, me vetveten, me njerëzit dhe me krijesat e tjera. Nëse pyetet se ndaj kujt duhet treguar besnikëri, pa dyshim që për një besimtar, i pari që vjen në mend është Krijuesi i gjithçkaje, Allahu Fuqiplotë. Ai është i pari ndaj të cilit besimtar i ndjen besnikëri në zemrën e tij, duke zbatuar urdhrat dhe duke qëndruar larg ndalesave. Pas besnikërisë ndaj Allahut, besnikëria më e lartë është ndaj Profetit Muhamed (a.s.). Kjo besnikëri bëhet e mundur me zbatimin e Sunetit të tij, pra, duke ndjekur rrugën e Profetit tonë të nderuar.

Jeta e sahabëve të nderuar është e mbushur me shembuj të besnikërisë. Fjalët e sahabëve drejtuar të Profetit (a.s.) para zhvillimit të Betejës së Bedrit do të mbeten në histori si shenjë e fuqishme e besnikërisë për shumë breza të mëvonshëm.

Pas zbritjes së ajetit të shtatë të sures Enfal, Profeti (a.s.) u tha shokëve të tij se lufta ishte e pashmangshme dhe u konsultua me ta lidhur me këtë çështje. Si rezultat i këtij konsultimi Mikdad

b. Amri, një nga myslimanët e Mekkes, u çua në këmbë dhe tha këto fjalë: "O i Dërguari i Allahut! Ti bëj atë që të ka urdhëruar Allahu. Ne jemi me ty. O i Dërguari i Allahut! Ne nuk të themi ty siç i thanë bijtë e Izraelit Musait (a.s.): Shko ti me Zotin tënd dhe luftoni me ta. Ne do të rrimë këtu.² Ne të themi: Ec (drejt armikut) dhe ne jemi bashkë me ty! Dhe betohem në Allahun i cili të ka dërguar me të vërtetën, se sikur të na prish deri në Berku'l-Gimad (një vend shumë i largët), ne do të marshojmë bashkë me ty deri atje." Ky qëndrim i muhaxhirëve e gëzoi tej mase të Dërguarin e Allahut, dhe kjo fjalë sikur ia largoi të gjitha shqetësimet.

Besnikëria është një virtut që duhet treguar ndaj kujt do dhe në çdo fushë ku është prezentë përgjegjësia. Veçanërisht duhet përmendur bashkëshorti dhe bashkëshortja ndaj së cilës personi gjatë gjithë jetës ka marrë përsipër të drejta e përgjegjësi dhe me të cilën ndan momentet më intime. Besnikëria e ndërsjellë, dashuria, respekti, ruajtja e nderit dhe e pastërtisë, qëndrimi pranë njëri-tjetrit në çaste të lumtura e të vështira, mbështetja morale e materiale për njëri-tjetrin etj., janë të gjitha çështje që mbajnë në këmbë familjen dhe për të cilat jepet premtim i ndërsjellë.

Gjithashtu, punëtori dhe punëdhënësi duhet t'i ndëtojnë marrëdhëniet e tyre në bazë të besnikërisë. Me besnikëri të punëdhënësit ndaj punëtorit, gjërat e para që vijnë në mend janë: Punëdhënësi duhet t'ia caktojë dhe njoftojë paraprakisht pagën punëtorit, t'ia paguajë atë para se t'i jetë tharë djersa në ballë, dhe t'i përmbahet marrëveshjes së bërë. Edhe punëtori duhet të jetë besnik ndaj punëdhënësit, duhet ta bëjë punën më së miri dhe duhet të jetë i ndjeshëm ndaj pasurisë së punëdhënësit si të ishte e tij.

Besnikëria mbi të gjitha është një cilësi profetike. Të gjithë të dërguarit e Allahut, nga profeti i parë

1. Rad, 13:20.

2. Maide, 5:24.

deri te i fundit, kanë qenë besnik kauzës së tyre dhe të besës kur lidhnin marrëveshje me njerëzit në jetën e përditshme. Profeti Muhamed (a.s.) nuk i ka harruar asnjëherë shokët e tij, të cilët luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugë të Islamit, derisa ranë dëshmorë. Herë pas herë ai shkonte në varrezat Xhenetu'l Baki dhe të dëshmorëve, i vizitonte dhe lutej për ta. Të afërmit e nënës së qumështit, Halimes, si dhe të gruas së tij të parë, Hatixhes, nuk i harronte. Sa herë që takohej me ta i nderonte dhe kujdesej shumë. Kur i paraqiteshin dhurata, ja dërgonte atyre. Shembujt e shumtë nga jeta e tij në këtë drejtim, janë dëshmi e gjallë e këtyre fjalëve.

Pas çlirimit të Mekes, Profeti ndenji 15 ditë aty. Disa nga Ensarët u shqetësuan dhe filluan të mendojnë se ai nuk do të kthehet më në Medinë. Fundja, Allahu i kishte dhënë çlirimin e vendit të tij ku kishte lindur dhe ishte rritur. Ndërkohë që Profeti ishte duke u lutur në kodrën Safa, e ndjeu shqetësimin e tyre dhe pasi mbaroi lutjen i pyeti: Për çfarë po flisni? Kur Ensarët ja shprehën shqetësimin e tyre, i Dërguari i Allahut, duke shfaqur një shembull të madh besnikërie u tha: "O Ensarë! I kërkoj mbrojtje Allahut që të bëj diçka të tillë. Unë jam shpërngulur në vendin tuaj. Jeta ime është jeta juaj, edhe vdekja ime do të jetë pranë jush." Pas këtyre fjalëve, Ensarët u qetësuan.

Mes besimit dhe besnikërisë ka një lidhje të ngushtë. Besnikëria është veçanti e njerëzve që kanë të përbashkëta në ndjenja, në mendime dhe në ide. Ndjenja si mëria, urrejtja dhe smira janë armiqtë kryesorë të besnikërisë. Ka pasur nga ata që besnikërinë e kanë përshkruar si njësim të njeriut me zemrën. E vërteta është se, ndër njerëzit që nuk kanë një jetë të zemrës e të shpirtit, nuk është e lehtë të bëhet fjalë për besnikëri.

Në ditën e gjykimit, kur njerëzit do të jenë shumë nevojtarë dhe kur askush nuk do të ketë mundësi ta ndihmojë tjetrin, besnikëria do të vijë në gjendjen e kapitalit më të çmueshëm. Ata që në këtë botë jetojnë me këtë cilësi, në botën tjetër do të marrin shpërblime të shumta dhe do të shpëtojnë për shkak të besnikërisë që do t'i ndihmojë në çastet e vështira.

Besnikëria e Ebu Bekrit ndaj Profetit tonë të dashur ka qenë gjithnjë një shembull besimi për t'u marrë si model. Përvoja e Israsë dhe Miraxhit e të Dërguarit të Allahut (a.s.) pas së cilës ai tha se kishte udhëtuar nga Mesxhid'ul-Harami në Mekke drejt Mesxhid'ul-Aksasë në Jeruzalem, për njerëzit që një mundësi e mirë e testimi të kësaj besnikërie. Idhujtarët u mblodhën dhe shkuan drejt e tek shoku i tij më i ngushtë e më besnik, Ebu Bekri, që t'i tregonin për këtë pretendim të

Muhammedit (a.s.) dhe të arrinin diçka me këtë. Me emocion dhe tallje i rrëfyej Ebu Bekrit udhëtimin e papërfytyrueshëm deri në Mesxhid'ul-Aksa të njeriut që ai e pasonte. Shpresonin që Ebu Bekri të pendohej dhe të kthehej në fenë e tij të vjetër. Por nuk e dinin se i kishin bërë llogaritë gabim. Sepse përballë tyre kishin Ebu Bekrin që ishte i pari prej burrave që i ishte përgjigjur ftesës së të Dërguarit të Allahut në të vërtetën, ishte besimtar që ecte vetëm drejt në rrugën e së vërtetës. Ai qartazi tha këto fjalë: "Nëse këtë e thotë ai është absolutisht e vërtetë." Pas këtij rasti myslimanët i dhanë Ebu Bekrit pseudonimin "Sidik" (Besniku).

I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Mos iu ndani besnikërisë, sepse besnikëria të shpie në mirësi, kurse mirësia të shpie në xhenet. Personi thotë vazhdimisht të vërtetën derisa tek Allahu regjistrohet si besnik. Ruajuni gënjeshtër! Sepse gënjeshtër të shpie në mëkate, kurse mëkatet të shpien në xhehenem. Njeriu flet vazhdimisht gënjeshtër derisa tek Allahu regjistrohet si gënjeshtar."*³

Besimtari është njeri i besueshëm. Besueshmëria është cilësi e tij. Ai është i drejtë në marrëdhëniet me njerëzit, nuk flet gënjeshtër, atë qëndrim që tregon me njeriun në prezencën e tij, atë qëndrim mban edhe në mungesë të tij, e çon në vend amanetin, është i drejtë në tregti. Dhe me këtë ndershmëri u ngjall besim edhe njerëzve të tjerë.

Ndjenja e besimit që është një nevojë e natyrshmërisë njerëzore, është kusht i pazëvendësueshëm që marrëdhëniet të mund të ecin në drejtim të shëndoshë. Aty ku nuk ekziston besimi, ka dyshim, ndërsa aty ku ka dyshim, nuk mund të bëhet fjalë për sinqeritet e unitet. Allahu i Madhërishëm i ka përshkruar besimtarët që do ta arrijnë shpëtimin duke vënë në dukje se, **"ata u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra."**⁴

Allahu është më i denji për t'ia respektuar amanetin. Çuarja në vend e amanetit të Allahut realizohet vetëm duke qenë "rob i mirë", domethënë duke bërë një jetë me të cilën do të jetë i kënaqur Allahu i Lartësuar. Rruga e kësaj është saktësuar qartë në këtë thënie të Profetit (a.s.): *"Thuaj: I besova Allahut dhe pastaj qëndro i paluhatshtëm!"*⁵ Besimtari duhet të veprojë gjithnjë me vetëdijen se çdo gjë që i është dhuruar është amanet për të, kudo dhe kurdo duhet të jetë besnik ndaj besimit të tij, dhe me këtë qëndrim duhet të fitojë cilësinë e "të besueshmit".

3. Muslim, Birr, 105.

4. Mu'minun, 23:8.

5. Muslim, Iman, 62.

DRITA E BESIMIT NË KOHËT MODERNE

Historia njerëzore është një udhë e gjatë në epoka, qytetërime, kultura dhe ngjarje historikë të ndryshme. Pavarësisht këtij realiteti të larmishëm, njeriun e kanë shqetësuar të njëjtat pyetje ekzistenciale në lidhje me natyrën qenies dhe jetës së tij. Si rrjedhojë, njeriu, veçanërisht mendjet e ndritura në mesin e tyre janë përpjekur të shqyrtojnë jetën dhe reflektojnë mbi kuptimin e saj duke i dhënë përgjigje nëpërmjet besimit, filozofisë dhe botëkuptimeve të ndryshme.

Ky rrugëtim drejt urtësisë do të nisë me reflektimin rreth realitetin të qenies tonë njerëzore për të pasur një botëkuptim mbi jetën dhe bashkëjetesën me ekzistencat e tjera. Allahu i ka dhuruar njeriut intelektin duke e veçuar dhe lartësuar atë ndër krijesat e tjera. Kjo dhuratë është një dimension i veçantë dhe thelbësor për kuptimin e jetës së tij pasi nëpërmjet saj ai mund të lartësohet në dimensionet më të larta të ekzistencës ashtu sikurse mund të zbrisë në gradën më të ulët të krijesave. Në fjalët të tjera, nëse një vepër e rrallë antike vlerësohet sipas mallit të saj një tregun e hekurave, në tregun e veprave antike ajo do ketë një vlerë të paçmueshme. Po kështu edhe njeriu është në vepër e rrallë e Zotit në mesin e krijesave. Ai është krijuar me potencialin dhe qëllimin për të qenë mëkëmbës dhe për të reflektuar shëmbëlltyrën e Tij në këtë botë. Nëse ai do ti përdorë këto potenciale duke mbetur i zhytur në kënaqësitë e kësaj bote, përkohshmërinë dhe vlerën e sa ë ulët, atëherë do të ishte në një humbje e madhe. Sepse ashtu sikurse një vepër arti merr vlerë jo nga materiali por nga artisti i saj, edhe jeta e njeriut si krijesa më e bukur dhe e veçantë merr kuptim dhe vlerë vetëm nëpërmjet lidhjes me Krijuesin e tij. Kështu besimi dhe lidhja me Zotin është rrugëdalja e vetme për të arritur qëllimet e larta të ekzistencës. Dijetari i madh Bediuzzaman Said Nursi do ta përshkruante kështu rrugëtimin e besimit në qenien njerëzore:

Dije me siguri se qëllimi më i lartë i krijimit dhe përfundimi më i lartë i natyrës njerëzore është besimi në Allahun. Dhe grada më e lartë e njerëzores brenda këtij besimi është Njohja e Allahut (marifetullah).

Dhe lumturia më e ndritshme dhe mirësia më ëmbël brenda kësaj njohje është Dashuria për Allahun (muhabbetullah). Dhe ngazëllimi më i pastër për shpirtin njerëzor dhe gëzimi më i sinqertë për zemrën brenda kësaj dashurie është kënaqësia e pakufishme e shpirtit (zevki-ruhani).

Njeriu është një qenie që priret të vuajë përtë shkuarën, të frikësohet dhe ndjejë pasiguri për të ardhmen dhe sfidat që ai përballlet çdo ditë në të tashmen. Pa dritën besimit, një jetë zhytur në shkujdesje dhe deri në mohim i përngjan shembullit të një njeriu i cili në terrin e natës gjendet në mesin e një ure ndërmjet dy luginave ku çdo gjë shfaqet si pasiguri dhe kërcënim për jetën e tij. Por, nëse ai do të ndezë kandilin do të arrijë të shikojë realitetin e gjërave që e rrethojnë për të gjetur udhën e sigurte. Kështu edhe në jetën e kësaj bote, e gjithë ekzistenca dhe universi është një perde midis njeriut dhe Krijuesit. Nëse njeriu i shikon si realitete në vetvete ai do mbetet i pafuqishëm dhe i dobët përballë tyre. Ndërsa nëse i vështron nëpërmjet besimit njeriu arrin të shikojë realitetin e tyre se çdo gjë në jetën e tij si dhe në ekzistencën përrëth është vetëm një shenjë dhe mundësi reflektimi për kërkuar dhe njohur Zotin.

Besimi te Zoti është një dritë e pashuar ku nëpërmjet saj njeriu arrin të lexojë vetveten. Allahu e ka krijuar njeriun si qenien më të lartë me potencialin për të reflektuar cilësitë e tij. Kurani na thërret vazhdimisht të reflektojmë dhe meditojmë mbi krijimin tonë për të gjetur Zotin. Kështu nëpërmjet dritës së besimit njeriu arrin të ndjejë dhe perceptojë thelbin e qenies së tij në thellësitë saj dhe qëllimin e ekzistencës. Në fjalë të tjera kështu do të shprehej poeti Abdurrahim Karakoç:

Je një libër i gjallë, Zoti të ka shkruar

Hapur rri, librat le të të lexojnë ty

Fytyrën tënde, vështrimi i Zotit le ta ndriçojë

Mehtapi' le të të përkulet, ty le të të lexojë

Në anën tjetër, drita e besimit ndriçon jetën dhe ekzistencën deri në caqet dhe thellësitë e saj. Njeriu arrin të shikojë kuptimin e brendshëm të universit

1. Dritë hëne

dhe ngjarjeve duke e perceptuar kështu realitetin dhe ekzistencën në përmasat e veta të vërteta. Pa dritën e besimit çdo gjë është një ekzistencë më vete dhe njeriu mbetet i vetëm përballë një universi të panjohur. Dhe mohimi e përshkon njeriun si një natë e errët dhe e ftohtë. Ndërsa me anë të besimit çdo gjë ka një qëllim dhe urtësi që ekziston. Dhe i gjithë universi është në shërbim të frytit të krijimit që është njeriu. Kështu besimi është porsi një zjarr i ngrohtë që i mbledh të tjerët rreth tij. Nëpërmjet tij njeriu mund të shikojë si miq të gjithë universin edhe njerëzit e tjerë duke mbjellë në mesin tyre dashurinë, solidaritetin dhe bashkëpunimit për tu mbledhur rreth të vërtetave ekzistenciale, vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta pavarësisht diversitetit në aspekte të caktuara të jetës.

Njeriu dhe i gjithë universi është një ekzistencë e mundshme që mund të mos ekzistonte. Dhe e gjithë ekzistenca është një reflektim, një hije e Qenies së tij. Pa Zotin çdo jetë mbetet pa kuptim dhe çdo realitet mbetet një iluzion. Andaj njeriu për të shpëtuar nga errësira e materies, e shkaqeve duhet të lidhet me Krijuesin e gjithçkaje. Ai duhet të ngjitet nën hijen dhe Kujdesin hyjnor të tij që zemra të ndriçohet nga drita e besimit. Allahu i Lartësuar thotë kështu në Kuranin Famëllartë:

Allahu është mik dhe ndihmëtar, i atyre që besojnë dhe Ai i nxjerr ata nga errësirat në dritë, ndërsa ata, që nuk besojnë, për mik kanë djallin, i cili i nxjerr ata nga drita e i shpie në errësirë. Këta janë banorët e skëterrës, ku do të qëndrojnë aty përgjithmonë.

Në këtë verset fjala "dritë" përmendet në numrin njëjës dhe fjala "errësirë" në numrin shumës. Për të kuptuar se Zoti është Miku i Vetëm për njeriun dhe Ai është burimi i vërtetë i dritës. Nëse ai e humb lidhjen me Zotin në fakt humb çdo dritë në jetën e tij. Sepse pasi njeriu e humb njëherë dritën e diellit do të humbë edhe dritën e yjeve të natës edhe dritën e agimit, edhe atë të qiriut. Në anën tjetër numri shumës dhe gjinia femërore e përmendjes së fjalës "errësirë" aludon për aftësinë shumuese dhe rrethin vicioz të saj ku njeriu mund të zhytet nga errësira në errësirë deri në humbjen e tij. Kështu do të shprehej dijetari i madh Ibn Ataullah el-Iskenderani:

Çfarë humbi ai që Atë e gjeti

Çfarë fitoi ai që Atë e humbi

Njeriu në jetën e tij individuale si dhe shoqëritë njerëzore përballen me kriza dhe dilema të mëdha sociale e shpirtërore që e trazojnë vazhdimisht shpirtin e tij. Në përpjekjen për zgjidhjen e tyre ai mbetet shpeshherë i kufizuar brenda shkakësisë dhe ligjësisë materiale të kësaj bote. Por në fakt shumë probleme individuale apo shoqërore me të cilat mund të përballemi, thellë-thellë janë reflektim i sëmundjeve shpirtërore. Si rrjedhojë si në aspektin individual edhe atë shoqëror njeriu duhet të formësojë jetën dhe ti qaset sfidave të ndryshme

duke u përkujdesur për botën e tij shpirtërore dhe duke ripërtërirë vazhdimisht lidhjen me Zotin e tij.

Jeta e njeriut është një përpjekje e gjatë dhe e vazhdueshme përtë besuar. Pasi besimi është gjithmonë i kërcënuar dhe joshur nga kënaqësitë e përkohshme. Po ashtu njeriu dhe besimtari ka mundësi të bjerë monotonin duke mbetur në sipërfaqësinë e gjërave pa arritur të pastrojë zemrën dhe shërojë shpirtin nga sëmundjet e tij. Si rrjedhojë drita e besimit zbehet dhe dobësohet duke penguar përvetësimin dhe thellimin e tij në natyrën njerëzore. Duke iu referuar edhe kuptimit të versetit të mësipërm, njeriu ka gjithmonë nevojë ta ripërtërijë besimin e tij, ta reflektojë në jetën dhe sjelljen e tij të përditshme për të lundruar gjithmonë në horizontet e pafundme të tij. Kësisoj nëpërmjet besimit njeriu do ti bëjë ballë sfidave në jetën e kësaj bote për të shpëtuar nga ndikimi ngjarjeve sipas fuqisë së besimit. Profetët, njerëzit e dashur të Zotit janë një shembull i bukur se si nëpërmjet fuqisë së besimit kanë arritur të sfidojnë të gjithë universin për ti udhëhequr shoqëritë njerëzore drejt dimensioneve më të larta shpirtërore dhe lumturisë në të dyja botërat.

Allahu e krijoi njeriun si qenien më të lartë dhe përsosur mbi ekzistencat e tjera duke e veçuar dhe lartësuar atë ndër krijesat e tjera. Por në anën tjetër, njeriu është një qenie e pafuqishme dhe me plot dobësi në këtë jetë. Ndërsa kafshët janë krijuar me njohuritë dhe instinkte të caktuara për të jetuar dhe përshtatur me jetën, njeriu duhet mësojë për jetën nga djepi deri varr duke filluar nga nevojat më të vogla fiziologjike deri të çështjet më abstrakte në lidhje me veten dhe shoqërinë. Kështu jeta e njeriut është një udhë e gjatë drejt njohjes së vetvetes dhe të vërtetës. Thelbi i saj është njohja e pafuqisë dhe dobësisë së tij. Dhe vetëm kur të kuptojë padenjësinë e tij njeriu do ti hapet dera e Hirit dhe Madhësisë së Zotit. Njeriu është një qenie e dobët përballë problemeve dhe fatkeqësive të panumërta në këtë jetë; një qenie e varfër përballë nevojave të pafundme; një qenie e vetmuar përballë dëshirave të pafund që dora e tij nuk mund ti arrijë. Nëse çdo gjë kuptohet më mirë me të kundërtën e saj; drita kuptohet nëpërmjet errësirës; nxehtësia nëpërmjet ftohtësisë dhe shija e ushqimit nëpërmjet nivelit të urisë; atëherë edhe njeriu duke njohur veten dhe thellësinë e dobësisë dhe pafuqisë së tij, do të ndjejë dhe kuptojë fuqinë dhe mëshirën e pashuar të Zotit. Dhe kjo gjendje do të reflektohet natyrshëm në lutjen, nënshtrimin dhe dorëzimin e njeriut pranë Krijuesit të tij. Sa bukur do të shprehej poeti dhe mistiku i madh Shemsi Tebrizi:

Kur krejt munohen me kanë diçka n'kit botë, ti banu një hiç! Caku gjithmonë le t'jetë vorfnia. Njeriu s'duhet pasë dallim prej vorbës. Nuk asht forma e jashtme që e mban vorbën të fortë, por asht shprastia që ka mrena. Sikur ajo gjaja që njeriun e ban njeri, nuk asht hamendja e unit, por asht vetëdija e mosqenies.

Në lidhje me përgojimin



Me Emrin e Tij, që s'ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij.¹

Kur'ani e kritikon dhe e ndalon përgojimin gjashtë herë në gjashtë shkallë në mënyrë të mrekullueshme, ashtu siç e shpreh vërseti vijues:

"A do të pëlqente ndonjëri prej jush të hante mishin e vëllait të tij të vdekur?"²

Ky vërset e kritikon dhe e ndalon përgojimin gjashtë herë, në gjashtë shkallë, në mënyrë të mrekullueshme. Kur vërseti u drejtohet atyre personave tashmë të përfshirë në përgojim, kuptimi i tij është si më poshtë:

Siç dihet, hemzeja në fillim të vërsetit është pjesëz pyetëse. Kjo i përshkon si ujë të gjitha fjalët e vërsetit; kështu secila fjalë fiton një kuptim tjetër të ri. Atëherë fjala e parë pyet me hemzen e saj:

A nuk keni ju arsye, e cila është vendi i pyetjes dhe i përgjigjjes, që të mos kuptoni se sa gjë e shëmtuar është kjo?

Me fjalën e dytë: **"A do të pëlqente..."**, hemzeja thotë:

A është zemra juaj, vendi i dashurisë dhe i urrejtjes, kaq e prishur sa që të dëshirojë gjënë më të urreyer?

Me togfjalëshin e tretë, **"Ndonjëri prej jush..."**, hemzeja thotë: Çfarë i ka ndodhur jetës suaj sociale dhe civilizimit, që e merr jetën e saj nga komuniteti, që të gjejë të pranueshme një veprim që helmon kështu jetën tuaj?

Me togfjalëshin e katërt: **"...Të hajë mishin..."**, hemzeja thotë: "Çfarë i ka ndodhur humanizmit tuaj që ju po e shqyeni mikun tuaj si të ishit bishë e egër?"

Me togfjalëshin e pestë: **"...e vëllait të tij..."**, hemzeja thotë? A nuk keni dhembshuri e ndjenjë fisnikërie që ju zhytni dhëmbët tek karakteri i njeriut të lënduar, i cili është vëllai juaj në kaq shumë aspekte? A ka logjikë një njeri i cili kafshon çmendurisht gjymtyrët e trupit të tjetrit?

Dhe me togfjalëshin e gjashtë: **"...të vdekur..."**, hemzeja thotë: ku është ndërgjegjja jote? A është kaq e prishur dhe e zhytur në vese natyra jote, sa që të shpërfillë e të mohojë me kaq babëzi, sa të hajë edhe mishin e vëllait të vdekur, kur ai duhet respektuar?

Pra, sipas kuptimit të përgjithshëm të vërsetit Kur'anor, sipas interpretimit të fjalëve të tij, shpifja dhe përgojimi janë të dënueshme e të urreyera nga mendja, zemra, humanizmi, ndërgjegjja, natyra dhe nga shoqëria. Atëherë shikojeni se si ky vërset e ndalon këtë krim në gjashtë shkallë të

përmbledhura e në gjashtë nivele të mrekullueshëm!

Përgojimi është arma më e urreyer që përdoret më gjërësisht nga njerëzit e armiqësisë, të smirës dhe të kryeneqësisë. Njerëzit me sedër nuk do ta përdornin kurrë një armë të shëmtuar si kjo.

Një burrë i shquar njëherë tha:

"Unë kurrë nuk do ta poshtëroja veten time duke cënuar armikun tim me përgojosje, sepse përgojimi është arma e njerëzve të dobët, të ulët e të këqinj." **Përgojimi nënkupton thënien e asaj fjale që do t'i shkaktonte mospëlqim e mërzi të personit për të cilin flitet në qoftë se ai do të ishte i pranishëm dhe do ta dëgjonte. Madje edhe në qoftë se ajo që thuhet është e vërtetë, ajo përsëri është përgojosje. Në qoftë se ajo do të ishte gënjeshtër, atëherë ajo konsiderohet njëherësh edhe përgojim edhe shpifje, pra një mëkat i dyfishtë i dënueshëm dhe i neveritshëm.**

Përgojimi lejohet vetëm në pak raste të veçanta:

I Pari: Në qoftë se ankesa i paraqitet ndonjë zyrtari, me qëllim që me ndihmën e tij të largohet e keqja dhe t'i jepet drejtësia.

I Dyti: Në qoftë se një person mendon të bashkëpunojë me një tjetër dhe vjen të kërkojë këshillën tënde dhe, ti i thua atij me pastërti dhe për hir të së mirës së tij dhe e këshillon atë me korrektësi e pa egoizëm: "Mos bashkëpunoj me të, sepse do të jetë në dëmin tënd."

I Treti: Në qoftë se qëllimi nuk është për ta zbuluar dikë, për t'i bërë keq e për ta turpëruar, por thjesht për t'i sqaruar e për t'i bërë të vetëdijshëm njerëzit, si shembulli kur thuhet: "Ja, ai budallai i shthurur shkoj në filan vend ku s'duhej."

I Katërti: Kur pesoni për të cilin flitet është një mëkatar i hapur, i paturp, i pashqetësuar për të këqijat që bën dhe, madje ai mburret me gjynahet dhe gjen kënaqësi tek gabimet e tij të bëra; dhe pa ngurrim mëkaton në mënyrën më të hapur. Pra, në rastet e veçanta të mësipërme, lejohet përgojimi për qëllime të pastra, pa ndonjë interes personal, pa paragjykim apo egoizëm. Ndërsa përveç këtyre rasteve, ajo i djeg veprat e mira ashtu siç djeg zjarri drurin.

Në qoftë se njeriu bën vetë përgojim ose e dëgjon atë me dëshirë, atëherë ai duhet të thotë:

"O Zot! Më fal mua dhe atë për të cilin fola keq! Dhe kudo që ta takoj personin e përfolur, duhet t'i kërkojë atij ndjesë, duke i thënë: "Më fal!"

الْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

"I Qëndrueshmi i Vetëm. Ai është i Qëndrueshmi i Vetëm!"

1. Kur'an, 17: 44

2. Kur'an, 49: 12

E mesmja e artë e umetit islam



Jeta reale ngrihet e qëndron nëpërmjet dijes dhe njohjes. Kushdo që neglizhon dhe nuk u kushton vëmendje studimit dhe mësimdhënies, ai ka vdekur edhe nëse akoma është gjallë; sepse qëllimi më i lartë për krijimin e njeriut është studimi, meditimi, fitimi i njohjes dhe përhapja dhe rrezatimi i saj tek të tjerët.

Ajo gjejmë në të "Mesmen e Artë Islame" shfaq shenjën dhe veçorinë të cilat i gjen, me të vërtetë, madje edhe tek aspektet më të pjesshëm me të cilat karakterizohet metodologjia islame dhe dallohet prej të gjitha metodave të tjera prej medhhebeve - shkollave juridike - legjislacioneve dhe filozofive. Me këtë të "Mesme të Artë" u ndërtua Civilizimi Islam në të gjitha vlerat e standardet, në burimet, në pikat e referimit dhe në të gjitha detajet dhe aspektet e veçantë. Madje, ne do të mund të thoshim: "Kjo e Mesme e Artë, në lidhje me metodologjinë islame dhe me civilizimin e tij, është 'Xhami i tij zmadhues' për rrezet e dritës së tij, për këndin e vështrimit të tij si metodologji dhe për pikëpamjen e tij."

E "Mesmja e Artë" e ka arritur dhe e arrin këtë rang,

sepse ajo i refuzon tejkalimin e padrejtë dhe ekstremin e kotë. Ajo përfaqëson natyrën njerëzore para se ta kërcënojë e cenojë ngjarjet e papritura dhe fatkeqësitë e zakonshme. Natyra njerëzore, në thjeshtësinë e saj, me intuitën e saj, me thellësinë dhe me vërtetësinë e shprehjes së saj, mishëron natyrën e bashkëlindur të cilën Allahu e ka ngulitur te njerëzit. Ajo është ngjyrimi i Allahut. Allahu deshi që e "Mesmja e Artë" të ishte ngjyrimi i Umetit Islam dhe karakteristika më e veçantë e metodologjisë së reformimit nëpërmjet Islamit. Allahu xh.sh. thotë: **"Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju."** (el-Bekare, 2: 143)

E "Mesmja e Artë" është e vërteta midis dy kotësive; është drejtësia midis dy padrejtësive; është maturia midis dy ekstremeve; është qëndrimi i drejtë që i përfshin të gjitha anët e vërtetësisë, drejtësisë dhe maturisë; është refuzuesi i ekstremit qoftë si tepri "Iftrat", ose si mangësi "Tefrit", sepse ekstremi që shmanget prej së "Mesmes së Artë" është anshmëri nga ana e stërmadhuesve për te njëri prej poleve të fenomenit; dhe duke qëndruar te

njëra prej dy pjatave të peshores i mungon ndërmjetësimi i së "Mesmes së Artë Gjithëpërfshirëse Islame" si dhe i mungojnë kapacitetet e dëshmisë dhe të dëshmuesve.

Kjo e "Mesme e Artë Gjithëpërfshirëse Islame" nuk është ajo që e mendojnë njerëzit e zakonshëm si "mungesa e një qëndrimi të qartë dhe të përcaktuar ndaj çështjeve dhe problemeve", sepse ai qëndrim është më i vështiri, i cili jo vetëm nuk anon me lehtësi te njëri prej dy poleve, por ai qëndrim është krejtësisht i pastër dhe i përjashtuar prej kuptimeve të "vulgarizuara" që përhapen prej treguesve dhe konceptimeve të terminologjisë së tyre mes masave të njerëzve. Gjithashtu ajo nuk është e "mesmja e artë aristoteliane", siç e mendojnë shumë prej njerëzve të kulturuar, prej studiuesve të filozofisë perëndimore dhe studentëve të saj, sepse të mesmen aristoteliane, të cilën e pa Aristoteli (322-384 para Krishtit), se "virtuti është e mesmja midis dy ekstremeve të ligësisë", në traditën aristoteliane është e krahasueshme me "pikën e fushës sportive" që ndan dy anët e fushës - dy ligësitë - në distancë të barabartë, duke garantuar për fushën mesin dhe të mesmen. Ajo është një pikë që ka të bëjë me sportin; është një qëndrim i palëvizshëm dhe është diçka tjetër që nuk ka lidhje me dy polet - anët - që të vendoset në mes, në qendër.

E "Mesmja e Artë" nuk është kështu në terminologjinë Islame. Në konceptimin Islam e "Mesmja e Artë" është, me të vërtetë, një qëndrim tjetër i ri; ama qëndrimi i tij në mes, midis dy të kundërtave përballë njëra-tjetrës; nuk do të thotë se ai është burimi i lidhjes me veçoritë e tyre, me pjesët dhe elementet përbërës të tyre; ajo është e kundërta e atyre të dyjave, por jo në çdo gjë. Kundërshtimi i saj me ato të dyja qëndron në refuzimin e kufizueshmërisë dhe mbylljes në veçoritë e pikërisht polit dhe duke përjashtuar të tjerët veç tij; qëndron në refuzimin e shikimit vetëm me një sy, duke parë veçse një pol të vetëm; qëndron në refuzimin e tij anshmërinë e stërmadhuesit dhe stërmadhimin e anshmërisë. Prandaj, ai është një qëndrim i tretë i ri. Tipari i tij dallues dhe forca e tij e shfaqin vetveten në faktin se ajo i bën bashkë dhe i jep formë çfarëdo gjëje që mund të mbledhë e formojë - si një simetri jo të papajtuueshme dhe jo të trilluar - prej veçorive, pjesëve dhe elementeve përbërës që ndodhen në të dy polet e kundërt. Kështu ajo është një e "Mesme e Artë Gjithëpërfshirëse" që dallohet nga ajo të cilën e shprehu filozofi i Grekëve.

E mesmja e artë gjithëpërfshirëse

Drejhtësia në të "Mesmen e Artë" është drejtësia midis dy padrejtësive. Peshorja nuk mund të drejtpeshojë, duke injoruar njërën prej dy pjatave të saj dhe as duke u veçuar prej atyre të dyjave, ashtu siç nuk mund të drejtohet ajo nëpërmjet anshmërisë të njëra prej dy pjatave të saj. Ajo do të drejtohej veçse nëpërmjet së "Mesmes së Artë Gjithëpërfshirëse", e cila grumbullon gjykimin e drejtë

prej të vërtetave, prej realiteteve, argumenteve dhe shpjegimeve të të dyja palëve kundërshtuese ndaj njëra-tjetrës, dy pjatave të peshores. Për këtë arsye, Profeti Muhamed a.s. tha: *"E Mesmja e Artë është drejtësia, 'Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë', të së Mesmes së Artë"*. (Transmeton Imam Ahmedi). Ky ishte interpretimi për realitetin e konceptimit të së "Mesmes së Artë në Islam".

Në Dritën e këtij kuptimi islam për terminologjinë e së "Mesmes së Artë" - kuptim i cili e dallon, duke e përshkruar atë me termin "Gjithëpërfshirës" - ne i lexojmë ajetet kur'anore që aludojnë për këtë veçori prej veçorive të metodologjisë islame lidhur me reformimin. Atëherë Umeti Islam janë: **"Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes"**. (El-Furkan, 25:67). Për rrugën e drejtë të së "Mesmes së Artë" aludojnë shumë ajete kur'anore, si këto: **"Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepër. / Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë."** (El-Isra', 17:26, 29). Atëherë, mos ji, as si monarkizmi i krishterë, as si asketizmi i të huajve dhe as si kafshëria e pashmë e shpëputja prej detyrimeve.

Nëse ne do të dëshironim të njihnim dallimin e madh, të cilin e mishëron e "Mesmja e Artë Gjithëpërfshirëse", dhe të njihnim vërtetësinë dhe sigurinë e tij për metodologjinë islame në reformim si dhe gjithanshmërinë që përçon ndikimet e saj kur ajo respektohet, zbatohet e vihet në praktikë, ne do të mundeshim ta bënim këtë, kur perceptojmë se si kjo e "Mesme e Artë" ka shfaqur dhe shfaq, në lidhje me reformimin islam, brezin e shpëtimit, duke e mbrojtur prej sflitjes, copëzimit, shpërbërjes dhe dualizmit kontradiktor, ashtu siç ndodhi në civilizimet e tjerë dhe kryesisht në civilizimin perëndimor. Nëpërmjet kësaj të "Mesmeje të Artë Gjithëpërfshirëse" metodologjia islame nuk e ka njohur kontradiktën për të cilën civilizimi nuk ka gjetur zgjidhje mes: Shpirtit dhe trupit, kësaj bote dhe botës tjetër, fesë dhe shtetit, subjektivizmit dhe objektivizmit, individit dhe shoqërisë, idesë dhe realitetit, lëndores dhe ideale, synimeve dhe mjeteve, të qëndrueshmes dhe të ndryshueshmes, të vjetrës dhe të resë, arsyes dhe njohurisë së transmetuar, të vërtetës dhe forcës, ixhtihadit dhe taklidit (arsyetimit deduktues dhe imitimit), fesë dhe shkencës, deri te më e fundit e dualiteteve, tek të cilat, kur metoda studimore kërkonte pjesën e së "Mesmes së Artë Gjithëpërfshirëse", ndodhi ndarja e madhe dhe e mirënjohur në filozofinë e civilizimit perëndimor të "materialistët", "idealistët", "materia", "idealizmi"; të "racionalistët", "teologët", "fetarët", "filozofët" dhe "besimtarët", qysh prej kohëve të grekëve të lashtë të atij civilizimi deri në rilindjen moderne të tij dhe gjer te realiteti i tij bashkëkohor.

E "Mesmja e Artë Gjithëpërfshirëse Islame" ka shfaqur për metodologjinë e reformimit islam brezin e shpëtimit, duke e mbrojtur prej këtyre dualiteteve, prej

copëzimeve dhe ekstremeve të tyre. Për këtë arsye ka qenë kriteri për islamizimin e metodave studimore dhe ideologjike si dhe për metodat e reformimit nëpërmjet Islamit. Thirrja reformatore e Imam Muhamed Abduh rrezatoi në fillimet e shekullit të katërmëdhjetë, sipas Hixhretit, në një realitet civilizues që dallohej me mbisundimin e plogështisë, ngurtësisë dhe imitimit në rrethet e studentëve të shkencës fetare - dhe ky ishte një ekstrem që e bllokonte fenë dhe reformimin Islam, duke i fshehur prej realitetit të jetës - dhe krijoi vërtet një boshllëk fetar në këtë realitet, duke e larguar metodologjinë e reformimit islam prej qenies së saj si rruga e Umetit për rilindje e progres. Gjithashtu, ky realitet civilizues u dallua me avancimin e modelit perëndimor në progresin dhe modernizimin të vendet islame në lindje, me atë model që erdhi në vendet tona nëpërmjet kalorësve perëndimorë modernë pushtues e kolonizatorë të botës islame. Ai model sigurisht dallohej me stërmadhimin tepër ekstrem. Kjo kuptohet kur ai anoi të bota e dukshme, duke refuzuar botën e padukshme, të dynjaja përballë fesë, tek individualizmi përballë kolektivit, të toka, duke refuzuar dominimin e qiellit dhe sheriatin e tij, të materia dhe pozitivizmi përballë shpirtit, të forca përballë së drejtës, të konflikti në vend të luftës mbrojtëse, dhe anoi tek arsyeja përballë njohurisë së transmetuar dhe ndërgjegjes. Ky model perëndimor e mbushi hapësirën filozofike, kulturore dhe politike me një shumësi të madhe "dualitetesh kontradiktore" të cilat shprehën dhe shprehin stërmadhimin e mangësisë "tefrit" përballë stërmadhimit të tepërisë "ifrat" të cilat mishëruan ngurtësinë, mendimin dhe imitimin që mbisundonin mes studentëve të shkencave fetare në vendet e lindjes islame në atë periudhë historike.

"E 'Mesmja e Artë Gjithëpërfshirëse' është metodologjia e Islamit në jetë, në të gjitha fushat e ndryshme të jetës individuale dhe shoqërore, sepse myslimani mund t'i kuptojë dhe t'i zbatojë ato në fushat e tjera."

"E 'Mesmja e Artë Gjithëpërfshirëse Islame' ka mishëruar për civilizimin tonë dhe për metodologjinë e reformimit Islam brezin e shpëtimit, duke e mbrojtur prej dualiteteve, copëzimeve dhe ekstremeve të tyre."

Për shmangien dhe ftohjen e të dyja qëndrimeve - domethënë, për plogështinë e studentëve të shkencave fetare dhe për mohimin e studentëve të shkencave perëndimore - ndaj metodologjisë së të "Mesmes së Artë Islame" në reformim dhe rizgjim, Imam Muhamed Abduh ngulmoi në dallimin e metodës së tij reformatore nëpërmjet së "Mesmes së Artë Gjithëpërfshirëse Islame". Ai shkroi rreth dallimit të qëndrimit të tij, të metodës dhe thirrjes së tij nëpërmjet kësaj të "Mesmeje të Artë", nga njerëzit e plogësht, të ngurtë, dhe të imitimit të asaj që është trashëguar, dhe nga njerëzit e ngurtë dhe të imitimit të asaj që erdhi nga perëndimi, dhe tha: "Unë kam pasur pikëpamje të kundërta lidhur

me thirrjen (domethënë, me metodën e tij të reformimit), duke kundërshtuar mendimin e dy grupeve të mëdha prej të cilave përbëhet trupi i Umetit: Kundra studentëve të shkencave fetare dhe atyre të ngjashëm me ta dhe kundra studentëve të shkencave dhe arteve të këtij shekulli dhe atyre që janë të ngjashëm me ta." Pastaj ai u shpreh se, kjo e "Mesme e Artë", tek e cila ai anoi dhe me të cilën dallohet metoda e tij reformatore, nuk është një zgjedhje personale, por ajo është metodologjia e Islamit, me të cilën ajo dallohet nga stërmadhimin ekstrem që goditi njerëzit e legjislacioneve të tjerë. "Vërtet u shfaq Islami, as thjesht shpirtërore, dhe as trupore e ngurtë, por njerëzore e drejtë, e "Mesme e Artë" midis atyre të dyjave, duke marrë pjesë prej të dyjave; ai iu shtua dhe iu rrënjos aq shumë natyrës njerëzore, sa që nuk i është rrënjosur kaq shumë të tjerëve. Për këtë arsye ajo e quajti vetveten 'Feja e Natyrës Njerëzore', gjë të cilën ia njohën edhe armiqët e saj sot, duke e konsideruar atë si shkollën e parë nëpërmjet së cilës u ngjiten fiset berbere në shkollën e civilizimit."

Kështu, e "Mesmja e Artë" është karakteristika dalluese e Islamit; është shkaku që e bëri Islamin fenë e natyrës së drejtë njerëzore; ajo pati për të shkollën e ngjitjes në rrugën e civilizimit, madje me dëshminë e armiqve para dëshmisë së miqve. Nëpërmjet kësaj të "Mesmeje të Artë" me të cilën u dallua Islami, u dallua edhe Umeti Islam prej popujve të legjislacioneve të mëparshëm, disa prej të cilave u ndryshuan e anuan në ekstremin shpirtëror; dhe siç u shpreh Muhamed Abduh: "Kjo që për shkak se njerëzit para shfaqjes së Islamit ishin në dy grupe: Njërit grup i imponoheshin traditat materiale, duke u interesuar veçse për pjesën trupore, si hebrenjtë dhe mushrikët; ndërsa grupit tjetër u përcaktoheshin me detyrim vetëm traditat shpirtërore, braktisja e dynjasë dhe gjithçka që ajo përfshinte prej kënaqësive trupore, si Krishterët, Sabeanët, grupimet prej idhujtarëve të Indisë dhe njerëzit e trajnimit shpirtëror. Ndërsa për Umetin Islam Allahu xh.sh. i bëri bashkë në fenë e tij dy të drejta: Të drejtën e shpirtit dhe të drejtën e trupit. Kështu ai është shpirtëror-trupor. Nëse do të dëshiroje, do të mund të thoshe se, Ai xh.sh. i dha atij Umeti të gjitha të drejtat njerëzore; prandaj njeriu është trup dhe shpirt, shtazor dhe engjëllor, sikur Ai të thoshte: 'Ne ju bëmë ju një Umet të së Mesmes së Artë, me qëllim që të njihni dy të drejta dhe të arrini dy plotësi.'" Meqenëse Suneti Profetik është shpjegimi profetik i elokuencës së Kur'anit, atëherë Suneti i të Dërguarit të Zotit dhe rruga e tij në vepra dhe fjalë ishin mishërimi i metodologjisë të së "Mesmes së Artë Islame". Është e mjaftueshme për ne nëse do t'i shqyrtonim biografinë e tij fisnike dhe fjalët e tij, të tilla si: *"Me të vërtetë kjo Fe është e fortë, prandaj hyni tek ajo me butësi, trajtojeni atë me lehtësi e kujdes."* (Transmeton Imam Ahmedi). *"Sigurisht, Feja e Zotit xh.sh është lehtësi."* (Transmeton Buhariu). *"Me*

të vërtetë Allahu xh.sh nuk më dërgoi mua si qortues të ashpër, por Ai më dërgoi si lehtësues.”(Transmetojnë Muslimi dhe Imam Ahmedi). Rrëfëhet nga Aisheja, Allahu qoftë i kënaqur prej saj: *“Sa herë që i Dërguari i Zotit bëhej të zgjidhte midis dy çështjeve në Islam, ai do të zgjidhte më të lehtën e atyre të dyjave sa kohë që ajo çështje nuk ishte mëkat; por në qoftë se ajo do të ishte mëkat, atëherë ai do të ishte më i larguari i njerëzve prej saj.”*(Transmeton Buhariu)

E mesmja e artë është metodologjia e Islamit

Meqenëse kjo e “Mesme Artë Gjithëpërfshirëse” është metodologjia e Islamit në jetë, në fushat e ndryshme të jetës individuale dhe shoqërore, arsyeja e myslimanit mund ta kuptojë e ta zbatojë atë në fushat e tjera.

Atëherë, “Bujaria” nuk është një sjellje dhe një qëndrim krejtësisht i huaj ndaj dy poleve të kundërt, “Koprracisë” dhe “Prishjes pa hesap”, por i bën bashkë, duke përfshirë, prej atyre të dyjave, veçoritë e kësaj bujarie dhe përbërësit e saj nëpërmjet grumbullimit prej sasisë së “kursimit dhe ekonomizimit” si dhe prej sasisë së “dhënies dhe shpenzimit”. Kështu në këtë (ky) është një bashkim i elementeve të së vërtetës dhe të së drejtës prej dy poleve të kundërt.

Po ashtu “Trimëria”. Ne e gjejmë të “Mesmen e Artë” të saj midis “frikës” dhe “zemërimit të tërbuar”; por ajo është një bashkuese midis sasisë së “paralajmërimit” të frikacakut dhe sasisë së “trimërisë” së gjaknxehtit të papërmbajtur, duke mos anuar tek asnjëra prej dy të kundërtave dhe as duke qenë krejtësisht e ndryshme nga ato të dyja.

Në filozofinë e Islamit lidhur me pasuritë, mallrat dhe ekonominë, ne e gjejmë “caktimin e zëvendësuesit” si të “Mesmen e Artë” midis “lirisë absolute” në pasuritë dhe midis “mohimit të plotë të lirisë” në pasuri. Kështu, njeriu është pronar dhe i lirë, është trashëgues, investues, shpenzues dhe përfitues, por si përfaqësues dhe zëvendës në pronësinë shoqërore prej Pronarit të Vërtetë Absolut, i Cili është Allahu xh.sh. Të gjitha pasuritë dhe pronat gjykohen nëpërmjet të drejtave të Allahut dhe detyrimeve të Tij, të cilat obligojnë barazi, përgjegjësi dhe solidaritet midis Umetit.

Lidhur me qëndrimin ndaj dallimit të njerëzve në shtresat shoqërore, Islami qëndron në të “Mesmen e Artë Gjithëpërfshirëse” midis “lirisë absolute”, e cila shkakton dallimin midis shtresave, dhe midis “utopizmit” që u ra shoqërive pa klasa. Atëherë është e natyryshme dhe e domosdoshme - duke u bazuar në dallimin e shtresave, synimeve dhe përpjekjeve - që njerëzit të jenë të dalluar në fitime dhe në pjesë, ama e “Mesmja e Artë” obligon që ky dallim të qëndrojë te caqet e barazisë dhe të solidaritetit, gjë e cila e bën Umetin si një trup të vetëm, gjymtyrët e të cilit solidarizohen, pavarësisht dallimit të rëndësishëm, dhënies dhe nevojave të secilës prej këtyre

gjymtyrëve.

Imam Ali bin Ebi Talib, Allahu qoftë i kënaqur me të, në kohën e kalifatit të tij, i tha valiut të tij për Egjiptin, El-Eshter En-Nahij: “Dije se njerëzit përbëhen prej klasave të ndryshme; progresi i njeriut varet nga progresi i tjetrit; dhe askush nuk mund t’ia dalë të jetë i pavarur prej tjetrit”.

Në lidhje me marrëdhëniet midis civilizimeve, e “Mesmja e Artë Islame” paraqet metodologjinë e “bashkëveprimit” që është e “Mesmja e Artë” mes stërmadhimit ekstrem në “izolim e mbyllje” dhe mes “ndjekjes dhe imitimit”. Kështu në “bashkëveprim” ka frymëzim për cilindo në atë që është një pjesëmarrje e përgjithshme njerëzore, pavarësisht dallimit në veçoritë që lidhen me identitetet, besimin dhe kulturën.

Gjithashtu, e “Mesmja e Artë” është metodologjia e “luftës mbrojtëse” kur prishet ekuilibri në marrëdhëniet mes civilizimeve, po ashtu edhe mes shtresave, sepse kjo - lufta mbrojtëse - është rruga e mesme, e cila mishëron lëvizjen shoqërore që largon pasoja dhe i rikthen marrëdhëniet në nivelin e ekuilibrit dhe të drejtësisë, duke ruajtur pluralizmin dhe dallimin mes grupeve të ndryshme. Lufta mbrojtëse është rruga e mesme mes “mosreagimit”, i cili sjell pasoja duke i bërë ato më të rënda, dhe mes “konfliktit” në të cilin i forti hedh përtokë të dobët dhe u jep fund pluralizmit, dallimit dhe diversitetit. Kur’ani Fisnik e ka refuzuar metodën e “konfliktit”, sepse ai zhduk rregullin e pluralizmit dhe të diversitetit, **“...u shkatërrua nga një furtunë shungulluese e rreptë, të cilën Allahu ua dërgoi atyre shtatë net dhe tetë ditë pareshtur. Atëherë mund t’i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura. A sheh ndonjë gjurmë të tyre?”** (El-Hak’kah, 69: 6-8). Kurse “lufta mbrojtëse” është një lëvizje që ekuilibron qëndrimet, duke bërë që të ruhen pluralizmi, diversiteti dhe dallimi, **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 41: 34)

Kjo e “Mesme e Artë Gjithëpërfshirëse Islame” është ngjyrimi i Allahut, të cilin Ai e dëshoi për Umetin Islam; është natyra islame e pastruar prej rastësive, aksidentaleve dhe pasojave; është xhami zmadhues i shikimit për pjesët përbërëse të metodologjisë islame dhe për shenjat dhe veçoritë e konceptimit të tij për “mendimin” e “jetën”. Allahu xh.sh. thotë: **“Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju.”** (El-Bekare, 2: 34). Gjithashtu, Profeti Muhamed a.s. tha: **“El-Uasat - e Mesmja e Artë - është drejtësia; ‘...Ne ju bëmë ju një Umet të së Mesmes së Artë...’.**

PARA ZOTIT TËND



Çdo mysliman fal 5 namaze në ditë, 150 në muaj, 1825 në vit. Kur e mendon këtë numër, shihet qartë rëndësia e namazit në Islam.

Vallë, çfarë fitojmë ne nga gjithë këto rekate? Në çfarë gjendje shpirtërore jemi kur falim namazin? A e falim atë sa për të thënë se jemi falur?

Vallë, a arrijmë t'ia japim hakun namazit? Në mënyrën më të thjeshtë këtë mund ta kuptojmë duke parë nëse na shtohen apo na pakësohen anët tona të këqija.

Nëse të këqijat shtohen, atëherë do të thotë se namazi nuk është falur ashtu si duhet.

Namazi është pastërti, përfitim dhe madhërim i Allahut. Namazi na kujton se jemi robër të Allahut, se jemi njerëz dhe kalimtarë në këtë botë. Namazi është pjekuri dhe nderim, është ndërmjetësues dhe dritë për ne. Ai është ngritje, është miraxh, sabër dhe falënderim...

O Zot, na bëj prej atyre që i japin hakun namazit.

Besimtari që pëlqente suren Ihlas

Ishte një person nga ensarët, i cili drejtonte namazin në xhaminë e Kubasë. Në çdo rekat që falte, ai lexonte edhe suren Ihlas dhe pas saj një sure tjetër. Një ditë shokët i thanë:

- Ti gjithmonë e lexon suren Ihlas e më pas sikur ajo nuk mjafton, lexon edhe një sure tjetër. Të mjafton vetëm surja Ihlas, ose vetëm një nga suret e tjera.

Tjetri u përgjigj:

- Kurrë nuk do ta braktis suren Ihlas. Nëse dëshironi më pasoni mua si imam, nëse jo, gjeni dikë tjetër që t'ju drejtojë namazin.

Ky lajm i shkoi edhe Profetit a.s. dhe një ditë, kur e pa imamin, i tha:

- Çfarë të pengon ty të dëgjosh shokët e tu? Përse e ndien të nevojshme leximin e sures Ihlas për çdo rekat?

Ai u përgjigj:

- O i dërguar i Allahut, unë e dua shumë këtë sure.

Profeti i tha:

- Ta dish se edhe e vetme, kjo dashuri të vendos ty në xhenet.

Profeti a.s. na ka treguar

Profeti ynë i dashur a.s. na ka treguar: "E merr Zoti një rob dhe ia nxjerr punët e mira dhe punët e këqija. Punët e mira fillojnë e pakësohen, ndërsa punët e këqija fillojnë e rëndohen dhe peshorja anon komplet nga punët e këqija. Zoti i thotë njeriut: "Robi Im, a ke ndonjë punë tjetër të mirë që të kujtohet?"

Njeriu përgjigjet: "O Zot, nuk më kujtohet asgjë. E shikoj se në ç'gjendje jam, por nuk mbaj mend asgjë që të mund të ma lehtësojë sadopak këtë barrë të rëndë". Atëherë Zoti i thotë: "Ti e ke edhe një punë të mirë, por e ke harruar" dhe jep urdhër që të vijë ajo punë e mirë. Engjëjt e sjellin atë në formë letre apo karte, në të cilën është shkruar LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH.

Njeriu kur e sheh mendon: "Çfarë do të bëjë një fletë letre përpara malit me gjynahe që kam bërë?" Por në momentin që kjo letër vendoset në anën tjetër të peshores, peshorja anon nga letra dhe kthehet komplet në krahun tjetër.

Njeriu habitet dhe pyet: "O Zot, si ka mundësi?" Allahu xh.sh. i përgjigjet: "Robi Im, ajo fjalë është fjala më e rëndë në gjithësi. Beto hem se po t'i vendosja qiejt dhe tokën në një krah të peshores dhe këtë fjalë në krahun tjetër, peshorja do të anonte nga kjo fjalë".

Fletë nga historia Islame

Kur myslimanët ishin në Medinë, dikush i erdhi për vizitë Profetit a.s., por ai nuk kishte se çfarë t'i jepte dhe i pyeti shokët e tij: "Kush e pret sonte mikun tim"? Doli dikush dhe tha: "Do ta pres unë, o profet i Zotit". Pastaj shkoi në shtëpi dhe pyeti gruan: "A kemi gjë për të ngrënë"? Ajo iu përgjigj: "Për Zotin, kemi vetëm ushqimin e fëmijëve". Burri ia ktheu: "Vëri fëmijët në gjumë". Kur erdhi koha e darkës, burri i thotë gruas: "Ule dritën e kandilit. Unë e ti do bëjmë sikur hamë, por miku duhet të hajë, se është miku i Profetit a.s. Nuk duhet të turpërohemi përpara këtij miku". Miku hëngri e u ngop, ndërsa fëmijët, burri dhe gruaja fjetën atë natë pa futur gjë në bark. Të nesërmen pas namazit të sabahut, Profeti a.s. u kthye nga xhemati, filloi të qeshte dhe tha: "Kush është ai që e ka pritur mikun tim mbrëmë"? Personi që kishte pritur mikun, nuk e ngriti dorën herën e parë e as të dytën. Kur Profeti vazhdoi të pyeste, ai tha me vete: "Duhet t'i përgjigjem Profetit a.s." dhe u ngrit e tha: "Unë e kam pritur mikun tënd, o profet i Zotit. A thua nuk e kam pritur mirë atë"? Profeti a.s. ia ktheu: "Mbrëmë Zoti ka qeshur dhe është kënaqur me ty, se veprimin tënd nuk e bëjnë shumë njerëz". Atëherë zbritën ajetet kuranore: "Nga myslimanët ka burra të tillë, që e harrojnë hallin e tyre dhe i japin tjetrit edhe pse kanë më shumë hall për vete". Zoti e do shumë atë që është i varfër dhe bujar. Bujaria e vërtetë është në shpirt. Zoti na bëftë njerëz bujarë, të pasur apo të varfër qofshim.

PAGUAJ SA TË DUASH

Pronari i shtëpisë ishte mërziur me qiramarrësin e tij të varfër, i cili s'kishte para t'i shlyente qiranë. Meqë shtëpia e tij ishte vjetruar, vendosi ta ndërtojë dhe njëherë nga e para që t'ia japë një qiramarrësi tjetër, sigurisht më të kamur se i pari. Teksa hiqnin dërrasat e njërit krah të shtëpisë, punonjësit gjetën një hardhucë mes dërrasave. Asaj i ishte ngulur një gozhdë në këmbë dhe nuk lëvizte dot. Pronari kur e pa mbeti gojëhapur dhe filloi të pyesë veten se si kishte mundur të mbijetonte kjo hardhucë në atë gjendje, pa lëvizur, pa ushqim, në lagështirë dhe në errësirë?!

Ai i urdhëroi punëtorët ta ndërprisnin punën dhe u tërhoq pas, duke pritur çfarë do të ndodhë me hardhucën. Në një moment, shfaqet një hardhucë tjetër e cila mbante në gojë ushqim. Ajo vazhdoi të zvarritej derisa mbërriti te shoqja e saj së cilës i dorëzoi ushqimin dhe u largua. Të gjithë u çuditën. Ata e kuptuan se kjo hardhucë, edhe pse për shumë njerëz është e pavlerë, ishte më e dhembshur me racën e vet, sesa shumë njerëz me njëri-tjetrin. Pronari thirri qiramarrësin e tij të varfër dhe i tha: "Ti do të banosh sërish në shtëpi".

Indiani dhe amerikani

Një indiani i ra shorti të ulej përbri një amerikani gjatë një udhëtimit me autobus. Pasi ishte nisur autobusi, amerikani iu drejtua indianit me mirësjellje dhe e pyeti nëse dëshironte të luante sa për të shtyrë kohën.

Indiani ishte i lodhur dhe qepallat po i mbylleshin për gjumë, prandaj i kërkoi falje me edukatë dhe u kthye nga dritarja që të merrte një sy gjumë.

Por amerikani nuk hoqi dorë nga ideja e tij. Ai i tha se loja ishte e thjeshtë dhe shumë argëtuese. Madje i shtoi se ai do i bënte një pyetje, nëse nuk e dinte i duhej të paguante 5 dollarë. Pastaj edhe indiani do t'i bënte një pyetje, e nëse ky nuk e dinte, do i paguante po 5 dollarë.

Por as kjo nuk e bindi indianin, i cili ishte i vendosur të mbyllte sytë.

Këtë herë, amerikani i tha: "Mirë, nëse nuk e di përgjigjen, do të paguash 5 dollarë, e nëse nuk e di unë, do të paguaj ty 500 dollarë".

Meqë amerikani nuk kishte ndërmend ta lërë të qetë dhe se oferta ishte goxha joshëse, indiani pranoi. Menjëherë amerikani i drejtoi pyetjen e parë: "Sa është distanca mes tokës dhe hënës?" Indiani nuk foli asnjë



fjalë, por nxori një pesë dollarësh nga portofoli dhe ia drejtoi amerikanit. Ky i fundit, pasi i mori i tha: "Mirë, tani e ke radhën ti të bësh pyetjen". Indiani e pyeti: "Cila është ajo gjë që ngjitet në mal me tre këmbë dhe zbret me katër këmbë?" Amerikanin u mendua, por nuk i erdhi në mendje asnjë përgjigje. Mandej, nxori laptopin dhe u orvat ta gjejë, por sërish dështoi. Hapi celularin dhe kërkoi në google, por sërish nuk gjeti gjë. U dërgoi e-mail shokëve dhe të njohurve, por askush nuk e dinte përgjigjen. Pasi i përdori të gjitha mundësitë dhe nuk gjeti gjë, nxori 500 dollarë dhe ia zgjati indianit, i cili pasi i mori, e falënderoi dhe i ktheu shpinën dhe ra për të fjetur.

Amerikanin nuk i erdhi hiç mirë nga kjo sjellje, prandaj e pyeti si me inat: "Mirë, por a nuk më thua, cila ishte përgjigja"? Pa folur fare, indiani nxori një 5 dollarësh tjetër, ia zgjati amerikanit dhe u kthye sërish për të fjetur.

Portokalli në shishe

Babai i tregoi një shishe të birit 9-vjeçar brenda së cilës ndodhej një kokërr e madhe portokalli. Fëmija u çudit se si kishte hyrë ajo kokërr portokalli brenda asaj shisheje me grykë të ngushtë. Ai u orvat ta nxjerrë portokallin nga shishja, por më kot. I habitur e pyeti të atin:

- Si ka hyrë kjo kokërr portokalli kaq e madhe në grykën e ngushtë të shishes?!

I ati, pa folur fare e mori përdore dhe të dy e panë veten të kopshti i shtëpisë. Mandej, babai mori një shishe boshe, e lidhi tek një degë portokalli dhe pastaj futi brenda shishes një filiz nga gryka e saj e ngushtë. Pastaj, të dy u larguan për në shtëpi. Me kalimin e ditëve, kokrra e vogël e portokallit që ndodhej në filiz filloi të rritej, derisa u bë aq e madhe, saqë nuk mund të nxirrej më nga shishja.

I ati këtë e pa si një rast të volitshëm për t'i përcjellë djalit të tij një mësim të rëndësishëm: - Të tilla janë vlerat dhe parimet morale. Nëse ato kultivohen tek një fëmijë që në vegjëli, është pothuaj e pamundur që të shkulen e çbëhen në moshë të rritur. O bir, në jetë do të ndeshesh me shumë njerëz, të cilët me gjithë intelektin, kulturën dhe statusin social mund të ndjekin një rrugë të gabuar që nuk u shkon për shtat. Ata mund të bien pre e veseve të liga dhe akteve të shëmtuara e të dënueshme për shoqërinë ku jetojnë. E gjitha kjo, sepse këto vese u janë kultivuar që në vegjëli dhe janë zhvilluar bashkë me ta. A nuk ishte e pamundur nxjerrja e portokallit nga shishja, veçse duke e thyer shishen?!

Fjala e dëshmisë

La ilahe il-lall-llah
Muhammedur-resul-ullah.

Fjala e dëshmisë
shenjë e dashurisë

Reze e jetës
thelb'i së Vërtetës

Gur'i besës
shkëndijë e shpresës

Dritë e amshuar
zjarr i pashuar

Gjurmë ndër shtigje
urë ndër brigje

Dy emra në fjali
më e shtrenjta stoli

La ilahe il-lall-llah
Muhammedur-resul-ull-llah.



Vazhdo!

A ka mbetur gjë pa u thënë?
A ke ngelur gjë pa u shkruar?
S'ka të re asgjë mbi dhe
Krejt janë thënë, por s'kanë mbaruar.

A ia vlen diçka të thuhet
Nëse s'ka vesh për këtë gojë
A duhet diçka të shkruhet
Nëse s'ka kush të lexojë

Derisa mbi këtë dhé ka
Një zemër që di të rrëfejë
Do të ketë edhe një tjetër
Që rrëfimin do ta ndiejë

Je pasqyrë e ekzistencës
Vazhdo veten ta lustrorsh
Veç kështu bëhet e mundur
Fytyrat t'i pasqyrosh

Sa më shumë veten lustron
Aq më shumë dritën pranon
Po s'tu shfaq asnjë fytyrë
Të mjafton që je pasqyrë.

El-Imam Abdullah b. Mahmud
el-Mevsilij el-Hanefij

EL-IHTIJARU LI TA'LILI-L-MUHTARI

الاختيار لتعليل المختار



Tiranë - Prishtinë - Shkup
2025